



Qeveria e Republikës së Maqedonisë

Komisioni Nacional i Luftës kundër Trafikimit me
Genie Njerëzore dhe Migrimit Ilegal

PROCEDURA STANDARDE OPERATIVE PËR TRAJTIMIN E PERSONAVE VIKTIMATË TRAFIKIMIT

Version i rishikuar, tetor 2010

PROCEDURA STANDARDE

OPERATIVE PËR TRAJTIMIN E

PERSONAVE VIKTIMA TË TRAFIKIMIT

Ky dokument është miratuar në seancën e 202 të Qeverisë së RM
28 Dhjetor 2010

Për përgatitjen e këtij dokumenti, mbështetjen e tyre e kanë dhënë:



Përmbajtja e këtij publikimi nuk përfaqëson medoemos këndvështrimin apo qëndrimin e Misionit Vëzhgues të OSBE-së në Shkup.



Përmbajtja e këtij botimi nuk përfaqëson domosdoshmërisht qëndrimet e Qendra ndërkombëtare për zhvillimin e politikave të migrimit.

Lista e shkurtesave

PSO	Procedurat standarde operative për trajtimin e personave- Viktima të trafikut
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
OP	Oficer i policisë
NjLKTPKM	Njësia për luftën kundër trafikimit të personave dhe kontrabandimit të migrantëve
SK	Spektori kufitar
NjMD	Njësia për mbrojtjen e dëshmitarëve
MPPS	Ministria e Punës dhe Politikës Sociale
QPS	Qendra për Punë Sociale
MNR	Mekanizmi nacional i referimit
QVT	Qendra për viktima të trafikimit
PP	Prokuroria Publike
LPP	Kodi i procedurës penale
KP	Kodi Penal
OJQ	Organizata joqeveritare
ON	Organizata ndërkombëtare
IQ	Institucione qeveritare
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
ICMPD	Organizata Ndërkombëtare për Zhvillimin e Politikave të Migrimit
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migrim
QR	Qendra rajonale
PK	Punë kufitare

Definicionet dhe terminologjia e përdorur

Ndihma dhe mbrojtja: Masat, programet dhe shërbimet që kanë për qëllim rehabilitimin e personave të trafikuar, siç parashihet në nenin 6 të Protokollit të Palermos mund të ofrohen nga institucione qeveritare, joqeveritare ose ndërkombëtare në vendet e destinacionit, të transitit dhe të origjinës. Mund të përfshijnë, por nuk kufizohen me, vendqëndrimin/strehimin, kujdesin mjekësor, ndihmën psikologjike, edukimin, formimin profesional, punësimin, ndihmën ligjore dhe transportin.

Person përgjegjës për rastin: është personi i caktuar nga MNR/QPS që bashkërendit veprimet e referimit dhe të dhënies së ndihmës për viktimat gjatë gjithë procesit, gjithmonë kur ka nevojë për këtë. Ky person (përgjegjës) për rastin e dhënë ka për detyrë të mbajë një dosje për viktimen dhe të ruaj të gjitha dokumentet e rëndësishme. Ky është pjesë e grupit të profesionistëve të tjerë që duhet të sjellin vendime për planin e mbrojtjes për secilën viktimë veç e veç.

Person i mitur: është secili person deri në 18 vjet moshë.

Mekanizmi nacional i pranimit dhe referimit të viktimave të trafikut: paraqet një sistem bashkëpunimi me të cilin institucionet kompetente dhe organizatat (MPPS, MPB, OJQ и ON) veprojnë në territorin e Republikës së Maqedonisë në fushën e parandalimit, mbrojtjes dhe referimit të viktimave të trafikut me qenie njerëzore. Zyra e mekanizmit nacional të referimit vepron në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale - Sektorit për shanse të barabarta.

Riintegrimi: është proces i risocializimit të viktimave me qëllim të inkuadrimit të tyre në familje dhe në komunitet, ose inkuadrimit në komunitet të ri. Riintegrimi paraqet gjithashtu një zgjidhje socio-ekonomike afatgjate për viktimen.

Kthimi: paraqet proces të përgatitjes, transportit dhe pranimit të viktimës në vendin e origjinës ose në vend tjetër përkatës.

Ofruesit e shërbimeve: janë organizatat dhe institucionet që ofrojnë ndihmë dhe mbrojtje për viktimat.

Qendra për viktimat e trafikut/Qendra strehimore për të huaj: janë objekte të cilat sigurojnë strehim të përkohshëm për viktimat dhe ato mund të jenë të karakterit të hapur ose të mbyllur.

Mekanizma ndërkombëtarë të referimit: janë mekanizma dhe sisteme të cilat janë ngritur për të ofruar ndihmë të gjithanshme viktimeve të trafikimit. Këta mekanizma ekzistojnë në vendet e transitit, të destinacionit dhe të origjinës duke angazhuar bashkëpunimin midis institucioneve përkatëse qeveritare dhe organizatave jo-qeveritar.

Viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore: është viktimë e veprës penale – trafikim me qenie njerëzore sipas nenit 418-a, dhe 418-g i KP. Në pajtim me nenin 122, paragrafi 22 të KP-së, një viktimë e një veprës penale është çdo person i cili ka pësuar dëme, duke përfshirë një dëmtim fizik ose mendor, vuajtje emocionale, humbje materiale ose llojet të tjera të shkeljes apo kërcënimit të lirive themelore dhe të drejtave të saj/tij si pasojë e veprës penale të kryer. Një fëmijë që është viktimë e një veprës penale është i mitur deri në moshën tetëmbëdhjetë vjeçe.

Viktimë e supozuar e trafikimit me qenie njerëzore: është personi për të cilin ka shenja se mund të jetë viktimë e trafikimit me qenie njerëzore, por nuk ka qenë zyrtarisht e identifikuar nga organet kompetente.

Mbrojtja e dëshmitarëve: paraqet një masë elementesh të sigurisë së nevojshme për të garantuar sigurinë e viktimeve në procedurat ligjore. Mbrojtja e dëshmitarëve mund të ofrohet para, gjatë dhe/ose pas përfundimit të procedurës penale dhe mund të përfshijë një masë të vetme ose një sërë masash të parapara me ligjin për mbrojtjen e dëshmitarëve.

PËRMBAJTJA

PJESA A	11
HYRJE	11
PROJEKTIM I NJË RRJETI TË BURIMEVE DHE TË REFERIMIT PËR PSO-në	13
PARIME THEMELORE	14
PJESA B	15
I PSO – IDENTIFIKIMI	15
MASA 1: REFERIMI FILLESTAR DHE PËRCAKTIMI I IDENTITETIT	16
MASA 2: DHËNIE PRELIMINARE E INFORMACIONEVE	17
MASA 3: VLERËSIM I HERSHËM I RREZIKUT	18
MASA 4: GJUHA DHE PËRKTHIMI	20
MASA 5: IDENTIFIKIMI	22
MASA 6: DHËNIE E INFORMACIONIT PAS IDENTIFIKIMIT	25
MASA 7: PERIUDHA E VENDOSJES DHE LEJA PËR QËNDRIM TË PËRKOHSHËM	26
II PSO: KUJDESI FILLESTAR DHE ASISTENCA AFATMESME	29
MASA 1: VLERËSIM I NEVOJAVE TË VIKTIMAVE	30
MASA 2: ZHVILLIMI I NJË PLANI NDIHME	31
MASA 3: PËLQIMI PËR ZBATIMIN E PLANIT TË NDIHMËS	32
MASA 4: ADAPTIM DHE STABILIZIM	33
III PSO – KTHIMI	35
MASA 1: PROCESI I VENDIMMARRJES PËR KTHIMIN E NJË VIKTIME	35
MASA 2: VLERËSIM I RREZIKUT DHE MUNDËSITË PËR PËRFSHIRJE SOCIALE	37
MASA 3: HARTIMI I PLANIT PËR MENAXHIMIN E RREZIKUT	39
MASA 4: GJETJA E FAMILJES	40
MASA 5: DOKUMENTET E IDENTIFIKIMIT	40
MASA 6: SHKËMBIMI I INFORMACIONIT ME VIKTIMËN	41
MASA 7: SHKËMBIMI I INFORMACIONEVE PËR VIKTIMËN PARA LARGIMIT TË SAJ	42
MASA 8: TRANSPORT I SIGURT/TRANSFER	44
IV PSO – RIINTEGRIMI	46
MASA 1: PËRGATITJE PËR RIINTEGRIM	46
MASA 2: PLANI I RIINTEGRIMIT	47

V PSO – PROCEDURA PENALE	49
MASA 1: GRUMBULLIMI I PROVAVE ME NDIHMËN E VIKTIMËS	49
MASA 2: PËRGADITJE E VIKTIMËS PARA GJYKIMIT	51
MASA 3: MBËSHTETJE PËR VIKTIMËS GJATË SEANCËS KRYESORE	52
MASA 4: MBËSHTETJE PËR VIKTIMËN-DËSHMITAR PAS PËRFUNDIMIT TË SEANCËS KRYESORE	53
MASA 5: MBËSHTETJE PËR VIKTIMËN NË PARAQITJEN E KËRKESËS PËR DËMSHPËRBLIM MATERIAL GJATË PROCEDURËS PENALE	54
PJESA C	57
ANEKSI 1: LISTA E ORGANIZMAVE PËRGJEGJËSE PËR PSO	57
ANEKSI 2: LISTA E ORGANIZMAVE TË BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTARË	60
ANEKSI 3: VENDIM PËR MBAJTJEN E PËRKOHSHME TË TË HUAJIT NË QENDRËN E PRANIMIT PRANË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME	80
ANEKSI 4: VENDIM PËR VENDOSJEN E PËRKOHSHME TË PERSONIT-VIKTIMË E TRAFIKIMIT ME NJERËZ NË QVT	82
ANEKSI 5: VENDIM PËR VENDOSJEN E PËRKOHSHME TË PERSONIT TË MITUR-VIKTIMË E TRAFIKIMIT ME NJERËZ NË QVT	84
ANEKSI 6: DEKLARATA E PËRKTHYESIT	86
ANEKSI 7: DEKLARATA E VIKTIMËS PËR NJOHJEN E GJUHËS	87
ANEKSI 8: FORMULAR PËR IDENTIFIKIMIN E VIKTIMËS SË TRAFIKIMIT ME NJERËZ	88
ANEKSI 9: KËRKESË PËR LËSHIMIN E LEJES PËR QËNDRIM TË PËRKOHSHËM	92
ANEKSI 10: FORMULAR PËR VLERËSIM TË FAMILJES	99

PJESA A

HYRJE

Procedurat standarde operative për trajtimin e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore rregullojnë procedurat dhe mënyrat e dhënies së ndihmës dhe mbrojtjes së viktimave të trafikimit me njerëz përmes një qasjeje të plotë të bazuar mbi të drejtat e njeriut dhe të përqendruar në viktimën në një kuadër të bashkëpunimit të institucionalizuar.

Bazat për vendosjen e PSO-së

Dokumentet kryesore për krijimin e PSO-së përfshijnë:

- Konventa e KB-së Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, me protokollet¹;
- Konventa e Këshillit të Evropës mbi masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore²;
- Konventa mbi të drejtat e fëmijëve³;
- Kodi Penal i RM-së⁴;
- Ligji për procedurë penale (me ndryshime që nuk kanë hyrë ende në fuqi)⁵;
- Ligji për të huajt⁶;
- Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve⁷;
- Ligji për të mitur⁸;
- Ligji për mbrojtje sociale⁹;
- Ligji për familjen¹⁰;
- Ligji për mbrojtjen e fëmijëve¹¹;
- Plani nacional i veprimit dhe strategjia për luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe migrimit ilegal 2009 – 2012;
- Udhëzime për referim ndërkombëtar të viktimave të trafikimit në Evropën Juglindore, botuar nga ICMPD¹²;

¹ http://www.unodc.org/pdf/crime/a_res_55/res5525e.pdf

² <http://www.coe.int/trafficking>

³ <http://www.unhchr.ch/html/menu3/b/k2crc.htm>

⁴ Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 37/96, 80/99, 4/2002, 43/2003, 19/2004, 73/2006, 7/2008

⁵ Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 15/2005, 150/2010

⁶ Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.35/2006, 66/2007

⁷ Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.38/2005, 58/2005

⁸ Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.87/2007

⁹ Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.79/2009

¹⁰ Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.80/92, 9/96, 38/2004, 33/2006, 84/2008

¹¹ Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 83/2009

¹² Udhëzime për referim ndërkombëtar të viktimave të trafikimit në Evropën Juglindore, *ICMPD*, 2006.

- Udhëzime për zhvillimin dhe zbatimin e një përgjigje të plotë kombëtare për të luftuar trafikimin e qenieve njerëzore botuar nga ICMPD¹³;
- Mekanizmi nacional i referimit. Bashkimi i të drejtave të personave të trafikuar. Doracak praktik publikuar nga OSBE-ja¹⁴;
- Parimet dhe udhëzimet e rekomanduara në lidhje me të drejtat e njeriut dhe trafikimit të qenieve njerëzore (si rezultat i Protokollit të OKB-së kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore) të publikuar nga UNHCR-ja;
- Raporti i Grupit të ekspertëve mbi trafikimin e qenieve njerëzore i hartuar për Komisionin Evropian, si dhe dokumentet e Grupit Punues të Paktit të Stabilitetit¹⁵.

Masat e PSO-së përfshijnë këto fusha:

- Identifikimin e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore;
- Statusin ligjor të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore;
- Ndihmën për viktimat e trafikimit (para kthimit, si dhe masat e riintegritit në vendin e destinacionit);
- Kthimin e viktimave të trafikimit;
- Asistencën dhe riintegrimin e viktimave të trafikimit, pas kthimit të tyre - në vendin e origjinës;
- Procedurat penale që i përfshijnë viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore si dëshmitarë;
- Kompensimin e dëmit.

Parime kryesore mbi të cilat bazohen PSO:

- Qasje që bazohet mbi të drejtat e njeriut;
- Qasje ndërdisiplinore dhe ndërsektoriale;
- Pjesëmarrja e shoqërisë civile;
- Pronësia e qeverisë;
- Qëndrueshmëria, dhe
- Parandalimi i trafikimit të qenieve njerëzore.

¹³ Udhëzime për zhvillimin dhe zbatimin e një përgjigjeje të plotë kombëtare për të luftuar trafikimin e qenieve njerëzore, ICMPD, 2006.

¹⁴ Kroeger, T. dhe J. Malkoc, B.H. Uhl, *Mekanizmi Kombëtar i Referimit. Bashkimi i të drejtave të personave të trafikuar. Doracak praktik*, OSCE/ODIHR, Varshavv, 2004.

¹⁵ Shih: <http://www.stabilitypact.org/trafficking/>

Si të përdoren PSO-të?

PSO përmbajnë pesë procedura:

- Identifikimin dhe referimin;
- Kujdesin fillestar dhe asistencën afatmesme;
- Kthimin;
- Riintegrimin; dhe
- Procedurën penale.

Çdo procedurë përfshin udhëzime në lidhje me:

- **Çfarë** masash duhet të zbatohen;
- **Kohën kur** do të zbatohen ato masa;
- **Kush** duhet të jetë përgjegjës për masat e propozuara; dhe
- **Si** do të zbatohen ato masa?

PROJEKTIM I NJË RRJETI TË BURIMEVE DHE TË REFERIMIT PËR PSO-në

Çfarë burimesh përfshijnë PSO-ja?

Procedurat standarde operative mbështeten në burime përkatëse, në personel të trajnuar dhe në kontakte individuale brenda institucioneve qeveritare dhe organizatave jo-qeveritare të cilat ekzistojnë në Republikën e Maqedonisë, ndërsa kur bëhet fjalë për rastet e viktimave të huaja – brenda organizatave qeveritare dhe jo-qeveritare në çdo vend tjetër.

Kur përcaktohen dhe sigurohen burimet e PSO-së?

Burimet, stafi dhe kontaktet janë përcaktuar në këtë dokument dhe duhet rregullisht të përcillen dhe plotësohen nga koordinatori nacional, komisioni nacional i luftës kundër trafikimit me qenie njerëzore, si dhe nga njësi të tjera organizative në MPB (NjLKTPKM) dhe MPPS (MNR).

Kush duhet të veprjë?

Procedurat standarde operative kanë të bëjnë me shërbime shumë-sektoriale që kanë për qëllim t'i mbështesin dhe mbrojnë viktimat e trafikimit me qenie njerëzore. Ato u kushtohen organeve kompetente të Ministrisë së Brendshme, Ministrisë për Punë dhe Politikë Sociale, organizatave joqeveritare (**↪ Shih Aneksin 1: Lista e autoriteteve përgjegjëse për PSO, f.57**). Autoritetet kompetente mbajnë bazë të dhënash – MPPS për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore dhe kryesit e veprave penale.

Si zgjidhen burimet?

Çdo burim i përcaktuar dhe i dakorduar do të zgjidhet në bazë të standardeve dhe strukturave të parapara në këtë dokument. Gjithashtu, të gjitha masat do t'u përshtaten nevojave konkrete të viktimës në rastin konkret.

PARIME THEMELORE

- Programet e ndihmës dhe mbrojtjes duhet t'u jenë të përshtatura nevojave të çdo viktime individualisht.
- Viktima duhet të japë pëlqim të informuar mbi të gjithë procesin e asistencës dhe mbrojtjes.
- Viktima ka të drejtë të zgjedh nëse dëshiron dhe kur dëshiron të ndihmohet.
- Çdo individ, që supozohet të jetë një viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore, do të trajtohet si një viktimë deri në konfirmimin përfundimtar.
- Të gjithë subjektet e përfshira në procesin e zbatimit të PSO-ve që kanë ardhur në kontakt me një viktimë të supozuar të trafikimit duhet t'i informojnë autoritetet kompetente me telefon/ose me shkrim.
- Të gjitha subjektet e përfshira në procesin e zbatimit të PSO-ve që kanë ardhur në kontakt me një viktimë të supozuar ose të identifikuar si viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore duhet të veprojnë në përputhje me parimin e mos-diskriminimit në bazë të gjinisë, moshës, statusit social, racës, fesë, bindjes politike etj.
- Intervistat duhet të kryhen duke respektuar të drejtat e njeriut dhe dinjitetin themelor të njeriut.
- Viktimat e përfshira në programin e mbështetjes duhet të kenë mundësi për të shprehur pakënaqësinë e tyre me shërbimet, personat e përfshirë në ofrimin e shërbimeve, ose me problemet me njerëz të tjerë në program ose probleme të tjera me të cilat përballen.
- Të gjitha informatat duhet të mbahen në fshehtësi dhe qasja t'u lejohet personave sa më pak të jetë e mundur.
- Në qoftë se viktima e trafikimit është i mitur, prania e prindit është e detyrueshme ose caktimi i një kujdestari.
- Gjatë dhënies të asistencës dhe mbrojtjes për të mitur, gjithmonë duhet marrë parasysh interesat e tyre më të mirë.

PJESA B

I PSO - IDENTIFIKIMI

ÇFARË është identifikimi?

IDENTIFIKIMI është proces ku përmes disa treguesve dhe intervistës grumbullohen informacione për të bërë vlerësimin nëse personi është viktimë e trafikimit me njerëz. Procesi i identifikimit parasheh:

- Referim dhe përcaktim të identitetit: viktima e supozuar referohet ose vetë-referohet pranë organit që është përgjegjës për referimin fillestar;
- Gjuhën dhe përkthimin: sigurohet bisedë në gjuhë që e kupton viktima e supozuar;
- Dhënie preliminare e informacioneve: grumbullim i të dhënave kryesore për viktimën e supozuar dhe përcaktimi i nevojave të saj/tij urgjente;
- Vlerësim të hershëm të rizikut: përcaktim të rrezikut për shëndetin dhe sigurinë e viktimës;
- Identifikimin gjatë së cilit (për të përcaktuar statusin e viktimës) parashtrohen pyetje dhe rishqyrtohen rrethanat për të përcaktuar vallë viktima e supozuar është viktimë e trafikimit ose e ndonjë krimi tjetër;
- Dhënie të informacionit pas identifikimit, marrje pëlqim nga viktima në bazë të shkëmbimit paraprak të informacioneve dhe përfshirje të viktimës në programin për ndihmë; për persona të mitur pëlqim nga prindi/kujdestari;
- Periudhë vendimi dhe leje për qëndrim të përkohshëm (për viktima me shtetësi të huaj) që mundëson rimëkëmbje dhe vendim që synon bashkëpunimin me organe kompetente dhe mundësi për të marrë leje qëndrimi të përkohshëm.

Një viktimë e supozuar mund të arrijë deri të autoritetet kompetente në mënyra të ndryshme: të paraqitet personalisht, nëpërmjet njerëzve të tjerë, si rezultat i të dhënave që i kanë në dispozicion policia, qendrat për punë sociale, inspektorët e punës, zyra e Prokurorit Publik, institucionet arsimore, organizatat shëndetësore, përmes personave të tjerë të trafikuar, familjes së tyre apo të njohurve të tjerë, organizatave jo-qeveritare ose ndërkombëtare, zyrtarëve të ambasadave ose konsullatave, personelit të transportit dhe të tjerëve.

Qëllimi i identifikimit është: të përcaktohen elementet e veprës penale trafikim me persona të mitur në pajtim me KP-në dhe viktimës t'i sigurohet qasja deri te shërbimet përkatëse për ndihmë në mënyrë sa më të shpejtë dhe më të përshtatshme.

Për çdo person caktohet një person përgjegjës:

- Për viktimat e vendit personi përgjegjës caktohet nga radhët e nëpunësve të MNR-së;
- Për viktimat e huaj personi përgjegjës caktohet nga radhët e policëve të NjLKTPKM-së.

Personi përgjegjës i caktuar për rastin që nga momenti i identifikimit të viktimës, do të kujdeset për viktimën nga fillimi deri në përfundim të procesit të riintegritimit dhe risocializimit.

Te gjitha elementet e kësaj faze realizohen me pajtim paraprak të viktimës. Në raste kur viktimë është person i mitur, nevojitet pajtimi i prindit/kujdestarit.

MASA 1: REFERIMI FILLESTAR DHE PËRCAKTIMI I IDENTITETIT

Çfarë?

Referimi fillestar paraqet njoftim të organeve përkatëse shtetërore për personin që supozohet se është viktimë e trafikimit me njerëz dhe referim të saj në Qendrën strehimore për të huaj ose QVT.

Në rast se viktimë e supozuar që është referuar nuk posedon dokumente identifikimi, MPB-ja ka për detyrë të përcaktojë identitetin e të viktimës nga vendi ose nga jashtë.

Kur?

Menjëherë pasi të paraqitet dyshimi se një person është viktimë e supozuar.

Kush?

- NjLKTPKM/MPB
- HPM/QPS/MPPS, dhe
- OJQ.

Si

Referimi bëhet në mënyrë që mos të shkaktojë rreziqe shtesë për jetën dhe shëndetin e viktimës.

Personat për të cilët ka dyshim se kanë qenë objekt trafikimi duhet të paraqiten në organet përkatëse.

Organet përgjegjëse kanë për detyrë të dërgojnë viktimën e supozuar në qendrat e strehimit për të huaj ose QVT duke sjell:

- Vendim për qëndrim të përkohshëm për të huaj në qendrën strehimore për të huaj (↪ **Shih Aneksin 3, fq.80**) ose
- Vendim për vendosje të përkohshme të personit – viktimë e trafikimit me njerëz në QVT. (↪ **Shih Aneksin 4 dhe 5, f. 82 dhe 84**)

Nëse viktima e supozuar është e mitur MNR/QPS njofton prindin ose cakton kujdestar.

MASA 2: DHËNIE PRELIMINARE E INFORMACIONEVE

Çfarë?

Dhënia e informacioneve viktimave të supozuara duhet të jetë pjesë përbërëse e gjithë procesit të referimit. Informacionet e dhëna mirë (me gojë ose me shkrim) u mundësojnë viktimave të supozuara të informohen, të rikthejnë vetëbesimin dhe të vendosin në mënyrë të pavarur.

Kush e bën bisedën?

- OP nga NjLKTPKM/MPB-ja;
- Persona zyrtarë përgjegjës nga QPS/MNR/MPPS.

Kur duhet të jepen informacionet?

Organi kompetent duhet menjëherë të japë informacione dhe viktimave të supozuara t'ua plotësojë nevojat urgjente.

Si duhet të jepen informacionet?

Informacionet fillestare duhet të jepen në afat sa më të shkurtër. Personi përgjegjës i cili jep informacionet këtë e bën në mënyrë të qartë, profesionale dhe me durim, duke nxitur viktimën e supozuar të parashtrijë pyetje dhe t'i kuptojë, ashtu si duhet, veprimet e personit që jep informacionet. Informacionet përkatëse duhet të jenë në

dispozicion edhe me shkrim dhe të përkthyer në gjuhën që viktimat e supozuar e kuptojnë.

Listë e parakushteve për të zhvilluar bisedën	
1	Bisedë për nevojat/kërkesat: <ul style="list-style-type: none"> • Nevojë kryesore/personale • Veshje • Pushim • Ndhimë mjekësore urgjente • Përdorim i telefonit • Përkthyes
2	Kujdes për sigurinë personale
3	Informacion për shërbimet në dispozicion për hapat e mëtejshëm të referimit dhe për periudhën e vendimit
4	Dhënie e materialit informues të shkruar
5	Pyetje nga viktimat

MASA 3: VLERËSIM I HERSHËM I RREZIKUT

Çfarë?

Qëllimi i kësaj bisede preliminare/fillestare është të kuptohet vallë viktimat ka ndonjë rrezik urgjent shëndetësor ose rrezik sigurie.

Ka për qëllim:

- Të vlerësojë rrezikun nga një kërcënim të drejtpërdrejt për jetën e viktimës të supozuar;
- Të vlerësojë nevojën për ndihmë urgjente mjekësore ose nevoja të tjera për mbështetje; dhe
- Së basku të përcaktohen hapat e mëtejshëm për t'i garantuar viktimës të supozuar siguri dhe mirëqenie.

Kur?

Kjo bisedë duhet të zhvillohet menjëherë pasi që viktimës të supozuar:

- Do t'i sigurohen nevojat kryesore;
- T'i sigurohen informacione rreth procesit të intervistës; dhe
- T'i ofrohet mundësia të parashtrijë pyetje, të paraqesë kërkesa dhe të japë pajtim për zhvillimin e mëtejshëm të bisedës.

Si nuk duhet zhvilluar bisedën?

Biseda nuk duhet të fillojë në rast se viktimat e supozuar:

- Ndodhet në vend të pasigurt;
- Ka nevojë për ndihmë mjekësore urgjente;
- Kërkon këshillë ligjore;
- Kërkon që biseda të shtyhet ose të refuzohet;
- Personi është i mitur dhe nuk është i pranishëm prindi/kujdestari ose përfaqësuesi i QPS,-së dhe/ose
- Nëse në vendin e eksploatimit është i pranishëm ndonjë person tjetër.

Viktimave të supozuara të cilat refuzojnë bisedën – ndihmën, duhet tu jepen kontakte të shërbimeve përkatëse në rast se më vonë vendosin të kërkojnë ndihmë.

Për viktimën e supozuar të mitur, e cila refuzon bisedën, vendos prindi/kujdestari ose përfaqësuesi i QPS-së.

Kush?

- OP nga NjLKTPKM/MPB;
- Persona zyrtarë përgjegjës nga QPS/MNR/MPPS; dhe
- Punonjësit shëndetësorë.

SI?

Vlerësimi i hershëm i rrezikut duhet të bëhet në vend të sigurt. Nëse ka mundësi, biseda duhet të zhvillohet në hapësirat e MPB-së, zyrës së MNR-së, në Qendrat për punë sociale dhe/ose në Qendrat për strehimin e të huajve/QVT.

Vlerësim i përgjithshëm i rrezikut	
A. Vlerësim fillestar i gjendjes shëndetësore	
1	Gjendja fizike dhe shenja dhune: <ul style="list-style-type: none"> • Lëndime të mëhershme dhe aktuale;
2	Gjendja psikike: <ul style="list-style-type: none"> • Pagjumësi; • Gjendje stresi - nervozë; • Depresion.
3	Gjendja shëndetësore – janë konstatuar: <ul style="list-style-type: none"> • Çrregullime psikike; • Çrregullime mendore dhe shpirtërore (dokument në aneks);

	<ul style="list-style-type: none"> • Gjendja shëndetësore mendore; • Gjendje me rrezik të lartë; • Faktorë të trashëguar; • Jetë me rrezik.
B. Vlerësim fillestar i rrezikut për siguri (mendimi i MPB-NjLKTPKM dhe QPS/MPPS)	
1	Kujdes momental për sigurinë
2	Kërcënime paraprake mbi sigurinë
3	Persona konkret që mund të shkaktojë problem
4	Shqetësime për sigurinë e pjesëtarëve të familjes ose miqve
5	Lokacione të rrezikshme për personin
6	Të tjera

Në rast se vlerësimi tregon se masat e mbrojtjes dhe të sigurisë janë të domosdoshme, atëherë duhet të ndërmerren veprime përkatëse për mënjanimin e rrezikut.

MASA 4: GJUHA DHE PËRKTHIMI

Çfarë?

Në rast se viktimat e supozuara që nuk kanë njohuri të duhura të gjuhës për të komunikuar me organet kompetente, përkthimi ka rëndësi thelbësore.

Kur?

Para se të fillojë procesi i identifikimit, duhet konstatuar vallë ka nevojë për përkthyes dhe, nëse ka nevojë, të sigurohet përkthyesi.

Kush?

- Përkthyes i autorizuar;
- Interpretues (person që e njih gjuhën e shenjave);
- OP nga MPB;
- Persona zyrtarë kompetent nga QPS në MPPS;

Në raste kur duhet të angazhohen përkthyes të paautorizuar, zgjedhja e tyre duhet të bëhet me kujdes që kjo të mos paraqesë rrezik plotësues për sigurinë e viktimës.

Përkthyesi firmos një deklaratë për saktësi dhe fshehtësi për informacionet që do t'i dëgjojë (→ *Shih Aneksin 6, Deklarata e përkthyesit, fq. 86*).

Personat që janë gjetur me viktimën nuk duhet të përdoren si përkthyes – madje edhe në rast se thonë se janë miq të saj/tij, familjarë etj.

Porositësi është ai që siguron dhe paguan përkthimin.

Si?

Duhet të vlerësohet vallë viktima e flet gjuhën në nivel të mjaftueshëm për të komunikuar në mënyrë efektive dhe të qartë. Viktimat e supozuara të cilat nuk pranojnë përkthim, firmosin deklaratë se e kuptojnë gjuhën dhe nuk kanë nevojë për përkthyes. (→ *Shih Aneksin 7, Deklaratë e viktimës për njohjen e gjuhës, fq. 87*).

Për viktimat e supozuara në moshë të mitur, deklaratën e firmos prindi/kujdestari.

Para se të fillojë biseda, viktimat e supozuara duhet, patjetër, të njohohen me rolin e përkthyesit, me detyrat dhe përgjegjësitë e përkthyesit, me të drejtën dhe mundësinë që e kanë të heqin dorë në çdo kohë nga përkthyesi i caktuar.

Përkthyesi në çdo kohë duhet të jetë i njoftuar me llojin e bisedës, dhe do të ishte më së miri të kishte përvojë paraprake ose nëse do ishte i trajnuar të punojë me persona të prekshëm. Përkthyesi qartë do t'i paraqiten detyrat dhe përgjegjësitë që i ka gjatë dhe pas bisedës.

Kriteret e zgjedhjes së përkthyesit	
1	Të mos e njohë viktimën prej përpara
2	Mos të jetë nga i njëjti vend ku jeton ose ku është gjetur viktima
3	Mos të ketë kryer vepra penale për të cilat parashihet dënim me burg mbi 3 vjet

MASA 5: IDENTIFIKIMI

Çfarë?

Përcaktimi i identitetit të personi për të cilin ka dyshim se është viktimë e trafikimit me njerëz bëhet përmes bisedës që e zhvillojnë përfaqësues të NjLKTPKM-së dhe/ose të MNR/QPS-së.

Kur?

Biseda duhet të zhvillohet atëherë kur viktimja do të ndjehet e gatshme dhe do pajtohet për ta zhvilluar atë, por jo më vonë se përfundimi i periudhës së adaptimit dhe vendimmarrjes.

Kur nuk duhet të zhvillohet biseda?

Biseda nuk duhet të fillojë nëse viktimja:

- Shfaq shenja shqetësimi, nervozizmi ose agresiviteti;
- Ka nevojë për ndihmë mjekësore dhe mbrojtje;
- Kërkon këshillë ligjore;
- Nuk e kupton personin që e zhvillon intervistën;
- Kërkon biseda të shtyhet ose refuzon bisedën; dhe
- Nëse është person i mitur dhe në bisedë akoma nuk është siguruar prania e prindit/kujdestarit ose përfaqësuesit të QPS-së.

Biseda me viktimën e supozuar mund të zhvillohet vetëm pasi të jetë njoftuar saktësisht me procesin e intervistimit.

Kush?

Personi përgjegjës për rastin:

- Përfaqësuesi i NjLKTPKM-së dhe/ose
- Përfaqësuesi i QPS/MNR-së.

Nëse ka nevojë biseda zhvillohet me ndihmën e përkthyesit, e nëse bëhet fjalë për person të mitur ose personi të cilit i mungojnë aftësitë e punës – ajo kryhet në prani të prindit ose kujdestarit.

Si?

Gjatë identifikimit duhet pasur parasysh këto përcaktime:

- Neni 418 (a) nga KP:

(1) Ai i cili me forcë, kërcënim serioz shpie në lajthitje ose forma tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, me keqpërdorimin e pozitës ose gjendjes së shtatzënisë, pafuqisë, ose paftësisë fizike ose mendore

të tjetrit, ose me dhënien apo marrjen e parave, ose përfitimeve të tjera me qëllim të marrjes së pëlqimit nga personi i cili ka kontroll mbi personin tjetër ose në mënyrë tjetër rekruton, transporton, bart, blen, shet, strehon ose pranon persona me qëllim të eksploatimit përmes prostitucionit ose formave të tjera të eksploatimit seksual, pornografisë, punës së detyrueshme ose shërbimit, skllavërimit, martesës së detyrueshme, fertilizimit të detyrueshëm, adoptimit të paligjshëm ose marrëdhënies së ngjashme me të, ose transplantimit të palejueshëm të pjesëve të trupit të njeriut, do të dënohet me dënim me burgim më së paku katër vjet.

(2) Ai i cili do të sekuestrojë ose shkatërrojë letërnjoftim, pasaportë ose dokument identifikimi të tjetërkujt me qëllim të kryerjes së veprës nga paragrafi (1) të këtij neni, do të dënohet me dënim me burgim më së paku katër vjet.

(3) Ai i cili shfrytëzon ose ia mundëson tjetrit shfrytëzimin e shërbimeve seksuale ose lloj tjetër të eksploatimit të personave për të cilët e ka ditur ose e ka pasur për detyrë ta dijë se janë viktimë të trafikimit me njerëz, do të dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet.

(4) Nëse veprën nga paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni e kryen personi zyrtar gjatë ushtrimit të detyrës, do të dënohet me dënim me burgim më së paku tetë vjet.

(5) Pëlqimi i viktimës së trafikimit me njerëz për shkak të qëllimit për eksploatim, i parashikuar në paragrafin (1), nuk është i rëndësishëm për ekzistimin e veprës penale nga paragrafi (1).

(6) Nëse veprën nga paragrafi (1) e kryen personi juridik, do të dënohet me dënim me para.

(7) Prona e paluajtshme e shfrytëzuar dhe sendet dhe mjetet e transportit të përdorura për kryerjen e veprës sekuestrohen.

- Neni 418 (g) nga KP:

(1) Ai i cili rekruton, transporton, bart, blen, shet, strehon ose pranon person të mitur me qëllim të eksploatimit përmes prostitucionit ose formave të tjera të eksploatimit seksual, pornografisë, punës së detyrueshme ose shërbimit, skllavërimit, martesës së detyrueshme, fertilizimit të detyrueshëm, adoptimit të paligjshëm ose marrëdhënies së ngjashme me të ose transplantimit të palejueshëm të pjesëve të trupit të njeriut, do të dënohet me burgim më së paku 8 vjet.

(2) Ai i cili veprën nga paragrafi (1) do ta bëjë me forcë, kërcënim serioz, me vënien në lajthitje ose formë tjetër të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, me keqpërdorimin e pozitës së tij ose gjendjes së shtatzënisë, pafuqisë fizike ose paaftësisë fizike ose mendore të tjetrit, ose me dhënien ose marrjen e parave, ose përfitimeve tjera me qëllim të marrjes së pëlqimit nga personi i cili ka kontroll mbi personin tjetër, do të dënohet me burgim më së paku 10 vjet.

(3) Ai i cili shfrytëzon ose i mundëson tjetrit shfrytëzimin e shërbimeve seksuale ose lloj tjetër të eksploatimit të personit të mitur, për të cilin e ka ditur ose e ka pasur për detyrë ta dijë se është viktimë e trafikimit me njerëz, do të dënohet me dënim me burgim më së paku 8 vjet.

(4) Ai i cili do të sekuestrojë ose shkatërrojë letërnjoftim, pasaportë ose dokument identifikimi të tjetërkujt, me qëllim të kryerjes së veprës penale nga paragrafët (1) dhe (2), do të dënohet me burgim më së paku 4 vjet.

(5) Nëse veprën nga paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 të këtij neni e kryen personi zyrtar gjatë ushtrimit të detyrës, do të dënohet me burgim më së paku dhjetë vjet.

(6) Pëlqimi i personit të mitur me veprimet e parashikuara në paragrafin (1), nuk është i rëndësishëm për ekzistimin e veprës penale nga paragrafi (1).

(7) Nëse veprën nga paragrafi (1) e kryen personi juridik, do të dënohet me dënim me para.

(8) Prona e paluajshme e shfrytëzuar dhe sendet dhe mjetet e përdorura të transportit për kryerjen e veprës sekuestrohen.

- Neni 122 nga KP:

Me viktimë të veprës penale nënkuptohet çdo person që ka pësuar dëm, përfshirë edhe lëndimin fizik ose mendor, vuajtje emocionale, humbje materiale ose cenim dhe rrezikim të të drejtave dhe lirive themelore të tij si pasojë e veprës së kryer penale. Me fëmijë si viktimë të veprës penale nënkuptohet personi i mitur deri në moshën tetëmbëdhjetë vjeçare.

Personat përgjegjës e kanë për detyrë të mbajnë dosje për viktimat dhe t'i ruajnë të gjitha dokumentet relevante, si dhe të sigurojnë mbrojtje të tyre, konform Ligjit për informata të klasifikuara. Personat e përfshirë në punën me viktimat është e nevojshme të posedojnë certifikatë sigurie me klasifikim rreptësishtë konfidencial.

Në qoftë se shtetasi i RM-së është kthyer nga vendi i tretë, të cilin organet kompetente të RM-së e kanë identifikuar si viktimë, ata do ta njoftojnë vendin e eksploatimit me qëllim të ndërmarrjes së masave përkatëse dhe gjetjes/përcaktimit të kryesit.

Personi përgjegjës për rastin e zhvillon intervistë në përputhje me formularin e bashkëngjitur. Këto të dhëna shfrytëzohen për marrjen e bazës së unifikuar të të dhënave dhe për ndjekjen e rastit. (→ [Shih Aneksin 8 Formular për identifikimin e viktimës së trafikimit me njerëz, fq. 88](#)).

MASA 6: DHËNIE E INFORMACIONIT PAS IDENTIFIKIMIT

Çfarë?

Gjatë fazës së dhënies të informacionit pas identifikimit të personit (pa varësisht nëse është identifikuar si viktimë e trafikimit me qenie njerëzore) i jepen informacione të detajuara për të drejtat që i ka në dispozicion, si dhe kushtet dhe detyrimet dhe, gjithashtu, i jepet mundësia të shprehë brengat dhe të parashtojë pyetje.

Pëlqimi i viktimës duhet të vijë si rezultat i informimit paraprak në lidhje me gjithë procesin e ndihmës dhe të mbrojtjes nga ana e organeve përgjegjëse. Viktima nuk mund të dërgohet në institucione të tjera kompetente pa e njoftuar me të drejtat që i ka në dispozicion dhe pa marrë pëlqimin e saj/tij.

Kur?

Menjëherë pas përcaktimit të statusit të viktimës, ajo/ai duhet të njoftohet menjëherë me të gritha shërbimet dhe procedurat.

Kush?

Personi përgjegjës jep informacione në lidhje me rastin.

Në qoftë se viktima dëshiron të kontaktojë me ambasadën e vendit të origjinës, atëherë personi përgjegjës i caktuar kontakton me ambasadën përkatëse dhe e njofton atë për kërkesën e viktimës.

Si?

Të gjitha informacionet që nevojiten do të sigurohen përmes personit përgjegjës me gojë ose me shkrim.

a) Nëse viktimat vendos të mos dëshmojnë, ajo/ai njoftohet me:

- Informacione për vlerësimin e rrezikut para kthimit;
- Informacione mbi mundësitë e kthimit;
- Informacione mbi ndihmën në dispozicion dhe kushtet për ndihmë të tillë.

b) Nëse viktimat vendos të dëshmojnë, i sigurohen informacione rreth:

- Qëndrimin të përkohshëm;
- Procesin të grumbullimit të provave;
- Procesin gjyqësorë dhe të drejtës për të kërkuar kompensime për dëm jo material;
- Mundësitë për dëshmi dhe mbrojtje; dhe
- Ndihmës që e ka në dispozicion, si dhe kushteve të mbrojtjes.

MASA 7: PERIUDHA E VENDOSJES DHE LEJA PËR QËNDRIM TË PËRKOHSHËM**Çfarë?**

Viktimave duhet t'u ofrohet një periudhë për rehabilitim dhe stabilizim dhe për të vendosur nëse do të bashkëpunojnë me autoritetet kompetente. Viktimave duhet t'u ofrohet kohë për të vendosur, pavarësisht nga vendimi i tyre për të bashkëpunuar ose jo, si dëshmitarë dhe pavarësisht faktit vallë kryesisht do të ndiqen penalisht ose jo. Periudha e vendimmarrjes duhet t'u ofrohet si viktimave të huaja ashtu dhe atyre të vendit.

Shërbimet e ofruara gjatë periudhës së vendimmarrjes:

- Strehim të përshtatshëm dhe të sigurt;
- Ndihmë mjekësore, psikologjike dhe sociale;
- Këshilla dhe informacione mbi të drejtat e tyre ligjore në një gjuhë që mund ta kuptojnë;
- Ndihmë ligjore për viktimën gjatë procedurës penale ose tjetër lloj procedure në të cilën viktimat ushtron të drejtat e saj/tij;
- Njoftim me procedurat përkatëse gjyqësore ose administrative, si dhe me të drejtën e shtetasve të huaj për të kërkuar azil;
- Njoftime për mundësitë dhe procedurat për kthimin e tyre në shtetet ku kanë shtetësi ose ku kanë pasur qëndrim të

ligjshëm para se të hyjnë në territorin e Republikës së Maqedonisë;

- Qasja në arsim.

Nëse një viktimë-e huaj ka vendosur të bashkëpunojë me autoritetet kompetente, pas periudhës për vendim, ajo mund të fitojë leje qëndrimi të përkohshëm. Leja e qëndrimit të përkohshëm mund të lëshohet për viktimat e trafikimit nëse:

- Nevojitet qëndrimi i tyre në Republikën e Maqedonisë për kryerjen e procedurës gjyqësore;
- Dëshmojnë synim të qartë për të bashkëpunuar me autoritetet kompetente të shtetit në zbulimin e veprave penale dhe autorëve të tyre dhe në qoftë se ata kanë ndërprerë kontaktet e tyre me njerëz për të cilët me arsye dyshohet se kanë qenë të përfshirë në kryerjen e veprës penale “Trafikim me qenie njerëzore”.

Kërkesën për lëshim/vazhdim të lejes për qëndrim të përkohshëm e paraqet OP nga NjLKTPKM në MPB në njësinë për të huaj në QR për PK. (⇒ [Shih Aneks 9, fq. 92](#)).

Kur?

Periudha e vendimmarrjes për viktimat vendore është deri në 2 muaj duke filluar nga dita e strehimit të viktimës. Në rastet kur viktimat janë persona të mitur, duke pasur parasysh interesin më të mirë të viktimës, periudha për vendim mund të zgjatet për 6 muaj.

Për viktimat e huaja – duke llogaritur nga momenti i referimit fillestar, viktimës së supozuar të trafikimit i lejohet një periudhë vendimmarrjeje prej dy muaj, ndërsa për personat e mitur parashihet mundësia për ta zgjatur këtë periudhë të vendim-marrjes. Leja e qëndrimit të përkohshëm lëshohet për një periudhë deri në 6 muaj me mundësi vazhdimi edhe për një periudhë tjetër 6 mujore.

Kush?

- OP nga NjLKTPKM-ja;
- OP nga SK;
- Personat zyrtarë nga QPS/MNR.

Si?

Hapin e parë në organizimin e periudhës për vendimmarrje e bën personi përgjegjës duke e informuar viktimën për rastin dhe duke synuar

të marrë pëlqimin e saj për veprimet e mëtejshme. Gjatë kësaj kohe, viktimat nuk duhet të merret në pyetje, por duhet të informohet në një gjuhë që e njeh.

Viktima me shtetësi të huaj vendoset në hapësira të veçanta në Qendrën e strehimit për të huaj në bazë të vendimit të marrë për strehim të përkohshëm për të huaj në Qendër strehimi nga ana e NjLKTPKM-së.

Gjatë periudhës së vendimmarrjes i huaji nuk mund të dëbohet nga Republika e Maqedonisë, me përjashtim të rasteve kur:

- Në mënyrë vullnetare, aktive dhe me vet iniciativë ka ripërtëritë kontaktet me personat për të cilët ekziston dyshim i arsyeshëm se janë përfshirë në kryerjen e veprës penale “Trafikim me njerëz”; ose
- Atë herë kur këtë e imponojnë arsyet që i përkasin rendit publik dhe sigurisë kombëtare të Republikës së Maqedonisë.

NjLKTPKM është e autorizuar të paraqesë kërkesë për leje për qëndrim të përkohshëm për viktimën-shtetas të huaj. Lejen për qëndrim të përkohshëm e lëshon Njësia për të huaj në QR për RK –në Lagjen Veri, Shkup. Qëndrimi i përkohshëm zgjat 6 muaj dhe mund të vazhdohet sipas nevojës. E drejta për qëndrim të përkohshëm anulohet në qoftë se:

- Viktima në mënyrë vullnetare, aktive dhe me vetiniciativë ka ripërtëritë kontaktet me personat për të cilët ekziston dyshim i arsyeshëm se janë përfshirë në kryerjen e veprës penale “trafikim me njerëz”;
- Këtë e imponojnë arsyet që kanë të bëjnë me rendin publik dhe me sigurinë nacionale të Republikës së Maqedonisë;
- Viktima ndërpret bashkëpunimin me organet kompetente për të zbuluar veprat penale dhe autorët; ose
- Organet kompetente vendosin ta ndërpresin procedurën.

II PSO: KUJDESI FILLESTAR DHE ASISTENCA AFATMESME

Kujdesi fillestar është hapi i parë në procedurën e ndihmës për njerëzit që kanë qenë viktimë të trafikimit me njerëz dhe ai ndërmerret gjatë periudhës së vendimmarrjes. Kujdesi fillestar ka për qëllim të kënaqë nevojat urgjente dhe kryesore të personit dhe t'i sigurojë:

- Akomodim;
- Ushqim;
- Veshje dhe nevoja të tjera themelore;
- Këshillim psikologjik dhe mbështetje psiko-sociale;
- Këshilla për ndihmë juridike; njoftim me dispozitat ligjore në lidhje me lejen e përkohshme të qëndrimit, kërkim të informacioneve në lidhje me problemet e mundshme ligjore pas kthimit në vendin e origjinës;
- Lehtësim të kontaktit me zyrën konsullore me pajtim të viktimës;
- Sigurim të dokumenteve (në bashkëpunim me zyrën konsullore);
- Lehtësimi të kontaktit me autoritetet në vendin e origjinës me pëlqim të viktimës;
- Ekzaminim dhe ndihmë mjekësore;
- Masa të sigurisë; ➔ [shih Vlerësimi i hershëm i rrezikut](#)
- Kontakt me familjen dhe /ose të afërm të tjerë nëse këtë e kërkon viktimë;
- Informim të organeve kompetente.

Kujdesi fillestar dhe ndihma e ofruar duhet të bazohet mbi një vlerësim të nevojave. Vlerësimin e kryen personi përgjegjës për rastin.

Gjatë fazës së ndihmës afatmesme, ofruesit e shërbimeve kanë për detyrë:

- Të ofrojnë siguri;
- Të sigurojnë shërbime mjekësore;
- Të sigurojnë ndihmë psikologjike dhe mbështetje;
- Të ofrojnë ndihmë juridike;
- T'i ndihmojnë viktimës të rikthejë vetëbesimin dhe stabilitetin; si dhe
- Të bashkëpunojnë gjatë planifikimit dhe përgatitjes së hapave të mëtejshme të viktimës.

Asistenca afatmesme do të sigurohet:

- Në Maqedoni, në qoftë se bëhet fjalë për viktimë të vendit;
- Në vendin e origjinës, pas kthimit të viktimës (nëse bëhet fjalë për viktimë të huaj); dhe/ose;
- Në vendin e destinacionit, në qoftë se viktima mbetet në vend më gjatë se periodha e vendimmarrjes, në bazë të lejes për qëndrim të përkohshëm (p.sh., si dëshmitar ose palë e dëmtuar).

MASA 1: VLERËSIM I NEVOJAVE TË VIKTIMAVE

Me qëllim të përcaktimit të masave të nevojshme për ta ndihmuar viktimën, gjithsesi duhet të kryhet vlerësim i nevojave.

Çfarë?

Vlerësimi i nevojave bëhet në bazë të kriterëve në vijim:

KRITERE PËR VLERËSIMIN E NEVOJAVE	
TË DHËNA TË DOSJES SË RASTIT	
1	Emri dhe mbiemri dhe/ose numri i dosjes së rastit
2	Vendi i origjinës
3	Gjuha
NEVOJA BAZË	
1	Akomodimi
2	Ushqimi
3	Medikamentet
4	Komunikimi me familjen
VLERËSIM I RREZIKUT	
1	Shqetësime aktuale të sigurisë personale
2	Individë të cilët mund t'i krijojnë probleme viktimës
3	Shqetësimi për familjarët ose për të afërmit
4	Vendet e mundshme të pasigurta në të cilat personi mund të shkojë ose t'i vizitojë
5	Të shihet vallë personi ka qenë i ndjekur në një interval kohorë të caktuar?
NEVOJA SHËNDETËSORE	
1	Ekzaminimi mjekësor i detyrueshëm
2	Analiza e gjakut, ekzaminimi mikrobiologjik
3	Sëmundjet infektive

4	Ekzaminimi gjinekologjik
5	Shërbimet stomatologjike
7	Problemet psikike dhe psikologjike
9	Gjendja me rrezik të lartë (sëmundje të zemrës, epilepsi, astmë)
10	Pengesa në zhvillim

Kur?

Vlerësimi i nevojave të viktimave të kryhet pasi të jenë njoftuar lidhur me shërbimet në dispozicion, kushtet dhe detyrimet në lidhje me ofrimin e shërbimit.

Kush?

Personi përgjegjës për rastin:

- Punonjësi i MNR/QPS-së në MPPS; ose
- OP nga NjLKTPKM-ja në MPB;
- Punonjësi shëndetësor;
- Përfaqësuesi i OJQ (QVT)-së; ose
- OP nga SK në MPB.

Si?

Përpara fillimit të procedurës për vlerësimin e nevojave, personi përgjegjës i rastit duhet:

- Të marrë parasysh informacionet që i ka marrë mbi rastin;
- Të shpjegojë qëllimin e procedurës së vlerësimit të nevojave të viktimës (p.sh. si do të përdoret, pse është e dobishme);
- Të shpjegojë se kush do të ketë qasje në informata;
- Të shpjegojë mundësinë e individit për të refuzuar përgjigjet e cilësdo pyetje; dhe
- Të bëjë ekzaminim të detyrueshëm mjekësor;
- Vlerësimi i nevojave të një viktimë të mitur duhet të kryhet në koordinim me prindin/kujdestarin e caktuar.

MASA 2: ZHVILLIMI I NJË PLANI NDIHME

Çfarë?

Plani i ndihmës është përshkrim i qartë dhe i detajuar i hapave të propozuar në lidhje me kujdesin e viktimës.

Kur?

Pasi të përfundojë procedura e vlerësimit të nevojave të viktimës.

Kush?

- Personi përgjegjës i rastit nga Qendra e strehimit për të huaj/QVT;
- Viktima;
- Grupi i mbështetjes (profesionistë të profileve përkatëse);
- Prindi/kujdestari.

Si?

Personi përgjegjës i rastit bashkërendit aktivitetet për realizimin e planit për të ndihmuar individin së bashku me ekipin për ndihmë të viktimës dhe me viktimën.

Komunikimi duhet të përfshijë:

- Informacione për mënyrën se si do të vazhdojë puna e ekipit të rastit;
- Vendqëndrimin;
- Kohën e takimit në vijim;
- Çfarë duhet të ndërmerret në rast të një rreziku të sigurisë;
- Nevojat për ndihmë psikologjike-sociale, mjekësore dhe ligjore.

Gjatë vlerësimit të nevojave për të miturit, ata duhet të lejohen të marrin pjesë në vendimet që kanë të bëjnë me programet e ndihmës, duke respektuar dëshirën dhe interesin e tyre më të mirë.

MASA 3: PËLQIMI PËR ZBATIMIN E PLANIT TË NDIHMËS

Çfarë?

Procedura për marrjen e pëlqimit kryhet ashtu që viktimat të kuptojë dhe të pajtohet me ndihmën, kushtet dhe me afatet.

Kur?

Pasi t'i shpjegohen viktimës kushtet dhe afatet e dhënies së ndihmës.

Kush?

Personi përgjegjës për rastin.

Si?

Viktimës duhet t'i bëhet një prezantim i qartë i shërbimeve të ofruara, në gjuhën që e kupton, për të cilat viktima duhet të japë pëlqim.

MASA 4: ADAPTIM DHE STABILIZIM**Çfarë?**

Procesi i adaptimit dhe stabilizimit përfshin:

- Paketa shërbimesh mjekësore dhe ndihma të nevojshme mjekësore;
- Ndihmë dhe mbështetje psiko-sociale me qëllim të:
 - Rritjes së ndenjes së pavarësisë dhe vetëbesimit të viktima;
 - Aktiviteteve socio-edukative;
 - Fitimit të njohurive dhe aftësi;
 - Përgatitjes për risocializim dhe riintegrim;
 - Vlerësimit të rrezikut të sigurisë; si dhe
 - Mbështetjes individuale psikologjike.
- Ndihmë juridike; dhe
- Mundësi për edukim/trajnim, për arsim profesional të rregullt për të miturit.

Kur?

Duhet të vijojë pas kujdesit fillestar.

Kush?

Kujdesi i adaptimit dhe i stabilizimit duhet të bëhet në shumë sektorë, prandaj edhe propozohet të kryhet në bashkëpunim dhe koordinim me organet kompetente, me:

- Punonjës social, psikolog dhe pedagog nga QPS-ja në MPPS dhe OJQ;
- Përfaqësues të autorizuar të MNR-së në MPPS; dhe
- Punonjës shëndetësorë/Kryqi i Kuq.

Si?

- Me takime/diskutime të koordinuara me anëtarët e grupit të mbështetjes;
- Vlerësime të progresit në fusha të ndryshme;
- Njoftim të viktimës në lidhje me vlerësimin e grupit;

- Vlerësim të rrezikut për njerëzit që planifikojnë të qëndrojnë në vendin e destinacionit/mendojnë të kthehen në mjedisin e tyre;
- Mekanizma të mbështetjes për njerëzit që dëshirojnë të qëndrojnë/të kthehen në shtëpi;
- Komunikim me institucionet e tjera.

Viktima mund t'i dorëzojë personit përgjegjës dhe/ose institucionit kompetent, një ankesë në lidhje me ndonjë vërejtje për shërbimet dhe procedurat e ofruara. Ankesa mund të paraqitet me gojë apo me shkrim. Personi përgjegjës i rastit dhe/ose autoritetet kompetente kanë për detyrë të shqyrtojnë pretendimet në ankesë në afat sa më të shkurtër dhe ta informojnë viktimën. Ankesa shqyrtohet në mënyrë institucionale. Paraqitja e ankesës në asnjë mënyrë nuk duhet të ketë ndikim negativ në ofrimin e shërbimeve.

III PSO – KTHIMI

Procesi i kthimit është vullnetar dhe i sigurt. Viktimave duhet t'u ofrohet mundësia të shprehen kur dhe si do të dëshironin të kthehen në shtëpi.

Mënyra:

Për viktima – shtetas të vendit:

- Përmes zyrës së MNR-së, në bashkëpunim dhe koordinim me NjLKTPKM-në në MPB dhe OJQ; ose
- Me kthim individual, me shpenzime të veta.

Për viktima – shtetas të huaj:

- Përmes institucionit qeveritar – në Republikën e Maqedonisë si organe kompetente janë: MPB, MPPS (në rast se bëhet fjalë për te mitur) dhe MPJ;
- Me mënyra të kombinuara p.sh. Institucioni qeveritar deri të OJQ ose Institucioni qeveritar përmes IOM-it etj.;
- Me kthim individual, me shpenzime të veta.

Një i huaj i mitur nuk duhet të kthehet në vendin e tij të origjinës ose në një vend të tretë, në se është pajtuar me këtë, derisa në këtë shtet të kryhet vlerësim i plotë i familjes (→ [Shih Aneksin 10: Formular për vlerësimin e familjes, fq.99](#)) dhe të jenë siguruar kushte të përshtatshme për pranim. Derisa të sigurohen kushtet e përshtatshme, të miturit duhet të mbeten në territorin e Republikës së Maqedonisë.

I mituri nuk duhet të kthehet në një vend të tretë, sepse kthimi i tij do të ishte në kundërshtim me Konventën për të drejtat e fëmijës, Konventën kundër torturës dhe dënimeve e trajtimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese, si dhe me Konventën Evropiane për Mbrotjtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore.

MASA 1: PROCESI I VENDIMARRJES PËR KTHIMIN E NJË VIKTIME

Çfarë është një vendim i informuar për kthim?

Një vendim i informuar për t'u kthyer është vendim i marrë lirisht nga viktima pasi që të jetë njoftuar plotësisht me mundësitë dhe me rreziqet që lidhen me vazhdimin e qëndrimit të saj në vendin e destinacionit, kthimin në shtëpi ose ndryshimin e vendbanimit/vendqëndrimit.

Kur?

Viktima duhet të pyetet në lidhje me vendimin e saj/tij për t'u kthyer në shtëpi gjatë procesit të ndihmës, veçanërisht:

- Menjëherë pas vetë identifikimit; ose
- Para përfundimit të periudhës së vendimmarrjes

Kush e konsulton viktimën në lidhje me vendimin e saj/tij për kthim?

Në qoftë se bëhet fjalë për viktimë – shtetas i vendit, kompetente për këtë gjë janë zyra e MNR-së dhe OJQ-së përgjegjëse.

Në qoftë se bëhet fjalë për viktimë – shtetas i huaj, atëherë kompetentë: janë NjLKTPKM në MPB dhe OJQ-ja e cila punon me viktimën. Në rast të kthimit vullnetar të viktimës në kuadër të programeve të organizatave ndërkombëtare, atëherë organizata ndërkombëtare duhet të konsultohet rreth vendimit dhe hollësive të tjera lidhur me kthimin e viktimës.

Si përgatitet viktima për të marrë vendimin për kthim?

Viktimës duhet t'i jepen informacionet e mëposhtme gojarisht dhe me shkrim në gjuhën të cilën viktima e kupton.

DHËNIA E INFORMACIONEVE	
	Informacionet
1	Informacione mbi mundësitë ligjore për të mbetur në vendin e destinacionit, siç janë: <ul style="list-style-type: none"> • Leja e qëndrimit • Mundësitë për azil • Shërbimet sociale në dispozicion • Mundësitë për përkrahje psikologjike dhe sociale • Mundësitë për ndihmë mjekësore • Mundësitë për kurse të gjuhës • Mundësitë për arsim dhe trajnim profesional • Informacion mbi gjendjen e tregut të punës • Mundësitë për akomodimi (strehim, apartamente) • Persona dhe organizata për kontakt
2	Informacion mbi mundësitë në vendin e origjinës: <ul style="list-style-type: none"> • Informacion mbi shërbimet sociale në dispozicion • Informacion për ndihmë të specializuar në dispozicion • p.sh. ndihmë psiko-sociale, ndihmë juridike • Mundësitë për ndihmë mjekësore

	<ul style="list-style-type: none"> • Mundësitë për akomodim • Mundësitë për arsimim të mëtutjeshëm dhe trajnim profesional • Informacion për pasoja të mundshme në vendin e origjinës • Informacion lidhur me persona dhe organizata për kontakt
Lloji i informacionit që i jepet viktimës do të varet nga fakti nëse personi është shtetas i vendit ose shtetas i huaj.	

MASA 2: VLERËSIM I RREZIKUT DHE MUNDËSITË PËR PËRFSHIRJE SOCIALE

Çfarë?

Vlerësimi i rrezikut dhe i sigurisë para kthimit është i rëndësishëm thelbësor për të siguruar sigurinë e viktimës dhe të familjes së saj.

Kur?

Menjëherë pas vendosjes së viktimës përkthimin e saj në shtëpi.

Kush?

Vlerësimi i sigurisë së kthimit kryhet në bazë të informacioni të dhënë nga:

- Viktima;
- MNR-ja në MPPS dhe NjLKTPKM-ja në MPB;
- Organizatat jo-qeveritare;
- Ministria e Punëve të Jashtme – përmes misionëve diplomatike dhe konsullore (MDK të vendit të origjinës së viktimës dhe MDK të RM-së në vendin e origjinës së viktimës);
- Organizatat ndërkombëtare.

Si?

Vlerësimi i rrezikut dhe i sigurisë bëhet duke i dhënë përgjigje pyetjeve nga pyetësi.

PYETJE TË PROPOZUARA	
1	Pyetje për viktimën <ul style="list-style-type: none"> • Si do të ndiheshit sikur të shkonit në shtëpi? • Ku do të ndiheshit të sigurt? • A ka kërcënuar dikush familjen/miqtë tuaj? • A ju ka kërcënuar dikush ju?

	<ul style="list-style-type: none"> • A e dinë autorët e krimit se ku jetoni ju/familja juaj? • A janë autorët e krimit pjesë e familjes suaj, miqve, ose pjesë e grupeve sociale të afërta? • Çfarë mund të bëhet që të ndjeheni i/e sigurt/ë? • Si do të reagojë familja/miqtë tuaj kur do të ktheheni në shtëpi? • A dëshironi të ktheheni në shkollë, në punë, në universitet, etj?
2	<p>Vlerësim i rrezikut nga ana e policisë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vallë kryesit e veprës penale i kanë kërcënuar familjen ose miqtë tuaj? • A janë kryesit e veprës pjesëtarë të familjes, miqve ose të ndonjë grupi social? • A e njohin kryesit vendqëndrimin e personit? • A është policia në vendin e origjinës e aftë dhe e gatshme për të mbrojtur viktimën nga represionet e mundura ose nga dhuna (në rastin e një viktime - shtetase të huaj) • A është ngritur padi penale kundër autorit të krimit? • A bëhet fjalë për vepër të një kryesi ose të një grupi të organizuar? Cili është raporti i tij/tyre me viktimën? • Vlerësimi i rrezikut përmes të dhënave që i ka policia, si dhe përmes informacionit të marrë nga palët e treta.
3	<p>Rreziqe gjatë përfshirjes sociale janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kërcënimi gjatë ndjekjes penale ose procedurës kundërvajtës për vepra të kryera gjatë periudhës së eksploatimit; • Kushtet e infrastrukturës – për qasje në vendbanim; • Mundësitë për mbrojtje (mbrojtja e dobët nga policia lokale); • Stigmatizimi, margjinalizimi, izolimi shoqëror; • Përfshirja në programin e viktimës-dëshmitar; • Qasja në shërbime sociale, institucione që sigurojnë akomodimin; • Sigurim të këshillimit mjekësor, psikologjik, ligjor; • Mundësitë për të vazhduar trajnimin profesional ose edukimin; • Mundësitë për strehim të përhershëm; • Mundësitë për siguri dhe pavarësi ekonomike afatgjate; • Mundësitë për kthim në familje, gjendja në familje (dhuna, etj?);

- Kushtet në komunitet;
- Trazirat civile;
- Gjendja psikike dhe fizike e viktimës.

Pas vlerësimit, viktima duhet të informohet menjëherë për rezultatet.

Shënim: Viktima duhet të kthehet në vendin e origjinës vetëm nëse është konstatuar se kjo nuk paraqet kërcënim për sigurinë e saj/tij. Nëse kjo nuk është e mundur, duhet të parashihet mundësia për ndërrimin e vendbanimit apo vendqëndrimin në vend të tretë (në përputhje me dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve).

MASA 3: HARTIMI I PLANIT PËR MENAXHIMIN E RREZIKUT

Çfarë është plani për menaxhimin e rrezikut?

Ky është një plan ku janë përcaktuar rreziqet me të cilat mund të përballen viktima si dhe familjarët ose të afërmit e saj/tij pas kthimit. Qëllimi i planit është të zvogëlojë rrezikun në nivel minimal dhe të sigurojë menaxhim efektiv.

Kur?

Pas vlerësimit të rrezikut dhe të sigurisë si dhe vlerësimit të përfshirjes sociale të viktimës.

Kush?

- NjLKTPKM në MPB;
- MNR/QPS në MPPS;
- Organizata joqeveritare; dhe
- Organizma dhe organizata kompetente në vendin e origjinës.

Si?

Hartohet plan i cili përmbledh rezultatet e ndryshme. Ndërkohë, NjLKTPKM harton pjesën e planit që ka të bëjë me vlerësimin e rrezikut dhe të sigurisë, ndërsa MNR harton pjesën në lidhje me rreziqet nga përfshirja sociale.

Pas hartimit të planit, viktima duhet të informohet për rreziqet në të cilat mund të hasë ajo dhe masat që do ndërmerren për të mbrojtur atë dhe të afërmit e saj.

Shënim: Plani duhet të rishikohet dhe të plotësohet në vendin e origjinës pas kthimit të viktimës.

MASA 4: GJETJA E FAMILJES

Çfarë?

Në qoftë se viktimja ka ndërprerë kontaktin me familjen e saj/tij, mirëpo ka shprehur dëshirën të kthehet, duhet të ndërmerren hapa për të vendosur këtë kontakt me familjen.

Kur?

Paralelisht me procesin e vlerësimit të rrezikut dhe mjedisit të sigurt.

Kush?

- NjLKTPKM në MPB;
- MNR/QPS në MPPS;
- MPJ-ja;
- Një organizatë ndërkombëtare, në varësi të rrethanave të rastit;
- Përfaqësitë diplomatike konsullore të RM-së;
- OJQ-të.

Si?

Institucionet/organizatat e përfshira do të përdorin të gjitha burimet që i kanë në dispozicion (bisedat me viktimën, kontaktet telefonike, palët e treta, të dhënat e policisë etj.)

MASA 5: DOKUMENTET E IDENTIFIKIMIT

Çfarë?

Kur viktimja nuk ka dokumente të identifikimit dhe/ose pasaportë, ato duhet të sigurohen.

Kur?

Dokumentet sigurohen kur viktimja nuk ka dokumente të identifikimit dhe / ose atëherë kur të krijohen kushtet për kthimin e saj/tij. Kohëzgjatja e lëshimit të dokumenteve varet nga specifikat e secilit rast.

Kush?

Procesin e sigurimit të dokumenteve e inicion personi përgjegjës për rastin nga NjLKTPKM, ndërsa zbatimi bëhet në bashkëpunim me shërbimet përkatëse të MPB-së, si dhe me institucionet dhe përfaqësitë e tjera konsullore dhe diplomatike.

Si?

Nëse viktima ka marrë vendimin për kthim vullnetar në vendin e origjinës, personi përgjegjës i rastit duhet të kontaktojë ambasadat ose konsullatat përkatëse dhe/ose institucionet e tjera kompetente dhe të kuptojë se si mund të sigurohet dokumentacioni i nevojshëm për udhëtim.

Personi përgjegjës nga NjLKTPKM inicion procedurën e kthimit të viktimites së huaj para SK – Njësia për të huaj, në QR për RK Veri, e cila fillon procedurën formale për kthimin e viktimites së huaj.

Shënim: Në dokumentet e udhëtimit nuk duhet të thuhet se personi është viktimitë ose emigrant ilegal. Në qoftë se viktima ka shprehur dëshirën për të kërkuar azil, gjatë procedurës së azil-kërkimit nuk duhet të kontaktohen ambasadat dhe përfaqësitë.

MASA 6: SHKËMBIMI I INFORMACIONIT ME VIKTIMËN

Çfarë?

Shkëmbimi i informacionit me viktimën ka për qëllim të sigurohet se viktima është plotësisht e njoftuar me procesin e kthimit në mënyrë që të arrihet integrimi i saj, si dhe të shmanget viktimizimi i ri.

Kur?

Menjëherë pas marrjes së vendimit për kthim.

Kush?

- Personi përgjegjës për rastin;
- NjLKTPKM në MPB;
- MNR/QPS në MPPS, dhe
- OJQ.

Si?

Viktima informohet dhe me të bisedohet për:

- Rezultatet e vlerësimit (për rrezikun dhe sigurinë, si dhe për përfshirjen sociale);
- Statusin e identitetit dhe për dokumentet e udhëtimit;
- Kushtet dhe mënyrën e transportit nga një vend në një vend tjetër ose brenda shtetit:
 - Me apo pa përcjellje;

- Me mjete transporti;
- Me mjete financiare;
- Me ndihmë gjatë transitimit;
- Për atë se cili do të pranojë viktimën pas mbërritjes;
- Si do të njohë përfaqësuesin e organizatës/institucionit pranues në transit dhe pas arritjes;
- Për rreziqet e sigurisë.
- Jepen informacione për ditët e para në vendin e origjinës ose vendbanimit:
 - Të drejtat dhe mundësitë për viktimën e kthyer;
 - Mundësitë për akomodim;
 - Mundësitë për mbështetje;
 - Të dhëna për kontakte me organizata/institucione përkatëse;
 - Rreziqet e sigurisë; si dhe
 - Informacione për riintegrim.

MASA 7: SHKËMBIMI I INFORMACIONEVE PËR VIKTIMËN PARA LARGIMIT TË SAJ

Çfarë?

Shkëmbimi i informacioneve mes vendit të origjinës dhe të destinacionit duhet të përcaktojë nevojat e ndihmës për viktimën në vendin e origjinës.

Kur?

Të paktën 10 ditë përpara kthimit.

Në rrethana të jashtëzakonshme kur siguria e viktimës është e rrezikuar, ky afat kohor mund të jetë edhe më i shkurtër (por jo më pak se 48 orë).

Kush?

- Personi përgjegjës i rastit;
- NjLKT PKM në MPB;
- OJQ-të; dhe
- Organizata/institucioni pranues.

Si?

Në mënyrë që të ofrojë ndihmë të menjëhershme dhe përkatëse, pas ardhjes në vendin e origjinës, vendi i referimit duhet të kontaktojë vendin e origjinës për ta koordinuar procesin e kthimit.

Personi përgjegjës i rastit harton një raport dhe jep rekomandime për ndihmë për viktimën drejtuar organizatës/institucionit pranues.

Njoftimi duhet të zhvillohet si më poshtë:

- Me kërkesë për ndihmë gjatë kthimit (transit dhe/ose pranim) nga institucioni/organizata referuese;
- Me konfirmim të kërkesës për ndihmë gjatë kthimit (transit dhe/ose pranim) nga ana e institucionit/organizatës pranuese për institucionin/organizatën referuese;
- Me kërkesë për ndihmë për riintegrim nga institucioni/organizata referuese;
- Me konfirmim për ndihmën gjatë riintegrit nga institucioni/organizata pranuese.

Informacionet të cilat organizata e referimit ia ofron organizatës pranuese duhet të përmbajnë:

- Emrin e viktimës;
- Datën e lindjes dhe vendbanimin në vendin e origjinës (në qoftë se kthehet në vendin e origjinës);
- Gjendjen shëndetësore aktuale ose gjendjen për të cilën ka dyshim ose rrezik për viktimën;
- Vlerësimin për siguri dhe për rrezik;
- Pasqyrë të shkurtër e nevojave për ndihmë; si dhe
- Datën dhe kohën e paraparë për largim (nëse ka).

Në mënyrë që të garantohet siguria e viktimës, duhet të ketë shkëmbim të informacionit mes organizatës së referimit dhe asaj të pranimit, si dhe me organizata të tjera në transit ose në kalimet kufitare. Informacionet duhet të përmbajnë:

- Të dhëna për udhëtimin (mjeti i transportit, emri i transportuesit etj.), data dhe ora e mbërritjes në destinacion;
- Njoftime për organizatën pranuese pas largimit të viktimës;
- Emri (emrat) i/e shoqëruesit(ve), nëse ka;
- Konfirmim se viktima do të pritët dhe për atë se kush do ta presë; si dhe
- Konfirmim se viktima ka mbërritur dhe se ka qenë e pritur në vendin e destinacionit.

Organizata pranuese zgjidhet nga radhët e institucioneve shtetërore dhe/ose organizatave jo-qeveritare duke pasur parasysh këto aspekte:

- Vlerësimin e rreziqeve për sigurinë e viktimës;
- Vendin e origjinës të viktimës;
- Moshën, gjininë dhe arsimi i viktimës; si dhe
- Programet e ndihmës që organizatat e caktuara/ofruese të shërbimeve i ofrojnë në vendin e origjinës, krahas nevojave specifike të viktimës.

MASA 8: TRANSPORT I SIGURT/TRANSFER

Çfarë?

Transporti i viktimës nga Qendra e strehimit për të huaj/QVT deri në vendin e banimit, respektivisht deri në vendin e origjinës, duhet të jetë i sigurtë.

Kur?

Pas vendimit për kthim dhe krijimit të kushteve për kthim të sigurt.

Kush?

- Për viktimat e vendit: MNR/QPS në MPPS, NjLKTPKM dhe NjMD (Njësia për mbrojtjen e dëshmitarëve) në MPB dhe OJQ;
- Për viktimat - shtetas të huaj: SK – Njësia për të huaj, NjLKTPKM dhe MPD në MPB.

NjLKTPKM shoqëron viktimën/dëshmitarin nga lokacioni i sigurt ku është vendosur deri te vendi përkatës (gjykata, prokuroria, institucioni shëndetësor, stacioni i policisë), ndërsa Njësia për mbrojtje të dëshmitarëve (MPD-ja) angazhohet vetëm në raste kur viktimja ka statusin e dëshmitarit të mbrojtur.

Si?

Viktima duhet të pajiset me të gjitha mjetet themelore të nevojshme për kthimin e saj, me:

- Dokumente të udhëtimit dhe/ose identifikimit;
- Buletë udhëtimi;
- Numra të telefonit në rast urgjence;

- Informacion se si të njohë personin që do ta pranojë pas arritjes dhe gjatë transitit;
- Sende personale;
- Person shoqërues/person përgjegjës, si dhe me
- Para.

Shënim: Nëse vlerësimi i rrezikut tregon se nuk ka nevojë për një shoqërues gjatë transportit, viktimë duhet të shoqërohet deri në vendin e nisjes, si dhe nga vendi i mbërritjes. Nëse bëhet fjalë për person të mitur, shoqërimi është i domosdoshëm.

IV PSO – Riintegrim

Duke pasur parasysh pasojat e veçanta fizike, psikologjike dhe sociale të cilat i vuajnë viktimat si pasojë e abuzimit dhe e shfrytëzimit të tyre, duhet të ndërmerren masa dhe procedura përkatëse për riintegrimin e tyre në familje, shtëpi dhe në komunitet.

Përmes hartimit dhe zbatimit praktik të programeve individuale për secilin person, veç e veç, në bazë të moshës dhe nevojave të viktimës, do të realizohet mbështetje përkatëse për risocializimin dhe riintegrimin e tyre në mjedisin ku kthehen.

MASA 1: PËRGATITJE PËR RIINTEGRIM

Çfarë?

Masat për ndihmë për riintegrim përfshijnë shërbime/aktivitete për mbështetje të viktimës. Për viktimat e vendit masat nënkuptojnë integrim në vendin e banimit ose në vend tjetër ku viktimat do të ketë mundësi të riintegrohet; - Riintegrimi nënkupton mbështetje për viktimën dhe familjen, shtëpi - dhe përgatitje për integrim në komunitetin lokal.

E njëjta vlen edhe për viktimën e huaj në shtetin e destinacionit nëse i është dhënë leje për qëndrim të përkohshëm.

Për viktimat e huaja, shtetit të origjinës i dërgohen rekomandime për riintegrim të viktimës pas kthimit të saj.

Kur?

Rekomandimet/udhëzimet për riintegrim duhet të jenë të përgatitur para kthimit të viktimës në vendin e banimit dhe duhet t'i vihen në dispozicion menjëherë pas mbërritjes së saj/tij. Njëkohësisht të gjitha dokumentet i dorëzohen QPS-së kompetente.

Procesi i riintegrimit të viktimave të vendit caktohet individualisht, varësisht nga nevojat e secilit rast.

Për viktimat e huaja procesi i riintegrimit fillon në vendin e destinacionit dhe zgjat deri në skadimin e lejes për qëndrim të përkohshëm, ndërsa vazhdon në vendin e origjinës.

Kush?

QPS-ja kompetente ku zbatohet riintegrimi /MNR në MPPS dhe OJQ; nëse bëhet fjalë për viktimë nga vendi.

Nëse bëhet fjalë për viktimë të huaj përgatitjen për riintegrim e zhvillon personi përgjegjës nga Qendra e strehimit për të huaj.

Si?

Plani për riintegrim është përgatitur në bazë të nevojave dhe të aftësive individuale të secilës viktimë që gjenden në:

- Programin për riintegrim të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore;
- Programin për riintegrim të fëmijëve viktimë të trafikimit me qenie njerëzore;
- Programin për riintegrim të personave (të rritur dhe fëmijë) me nevoja të veçanta - viktimë të trafikimit me qenie njerëzore.

MASA 2: PLANI I RIINTEGRIMIT

Çfarë?

Plani i riintegrimit parasheh:

- Mbështetje psiko-sociale;
- Mbështetje juridike;
- Mësim të gjuhës;
- Edukim dhe/ose trajnim profesional; dhe
- Këshillim dhe ndihmë në lidhje me punësimin.

Plani duhet të bazohet mbi nevojat e viktimës dhe të zhvillohet në bashkëpunim me QPS-në e vendit të banimit.

Ky plan është fleksibil dhe mund të ndryshohet dhe të plotësohet.

Kur?

Për viktimat vendore të cilët nuk kanë qenë të vendosura në QVT, plani i ri-integrimit hartohet menjëherë pas vlerësimit të nevojave të përgatitur nga ekipi i ekspertëve të QPS-së kompetente. Për viktimat e strehuara në QVT, plani i riintegrimit hartohet 8 ditë para largimit të tyre.

Në rastin e viktimave të huaja të vendosura në Qendrën e strehimit për të huaj, informacionet, me qëllim të hartimit të një plani përkatës

për riintegrim në vendin e destinacionit, duhet të dorëzohen, të paktën, 8 ditë para se viktimat të kthehet në vendin e origjinës

Kush?

- Personi përgjegjës i rastit;
- Prindi/kujdestari;
- Viktima;
- OJQ; dhe
- QPS/MNR në MPPS, në bashkëpunim me:
 - Përfaqësues të bashkësisë lokale;
 - Agjencisë për punësim; dhe
 - Njësisë rajonale të Ministrisë së Arsimit.

Si?

Plani i riintegrit duhet të hartohet para se të largohet viktimat nga QVT-ja, por vetëm nëse viktimat jep pëlqim për të marrë ndihmë plotësuese. Nëse bëhet fjalë për person të mitur - viktimë e trafikimit, hartimi i planit është i detyrueshëm.

Nëse viktimat nuk dëshirojnë të përfshihen në një program të riintegrit, do t'i ofrohen informacione mbi institucionet dhe organizatat të cilave mund t'u drejtohet më vonë.

Informacionet që i siguron vendi i destinacionit për vendin e origjinës duhet të përmbajnë:

- Të dhëna për viktimën (nëse kthehet në vendin e origjinës);
- Datën e lindjes dhe vendin e banimit në vendin e origjinës (në qoftë se kthehet në vendin e origjinës);
- Të dhëna për gjendjen aktuale shëndetësore dhe psikologjike të viktimës;
- Vlerësimin e sigurisë dhe rrezikut;
- Një pasqyrë e shkurtër të nevojave për ndihmë;
- Rekomandimet/udhëzimet për hartim të një plani për riintegrim në vendin e origjinës;
- Datën dhe kohën e paraparë për nisje, nëse ka të tillë; si dhe
- Llojin dhe mënyrën e transportit të viktimës.

V PSO – PROCEDURA PENALE

Viktima – shtetase e huaj, përfshihet në procedurën penale nëse vendos të bashkëpunojë me policinë dhe autoritetet kompetente gjyqësore.

Në bazë të dispozitave të LPP-së, çdo person - duke përfshirë edhe viktimën e trafikimit me qenie njerëzore, që është thirrur si dëshmitar, është i detyruar të paraqitet dhe të japë deklaratë. Në qoftë se ekziston mundësi që, duke dhënë një deklaratë të tillë apo duke iu përgjigjur pyetjeve, dëshmitari të ekspozonte veten në rrezik jete apo integritetin personal, ai/ajo mund të refuzojë të japë deklaratë dhe mos t'i japë të dhënat personale. Dëshmitari nuk është i detyruar të përgjigjet në ndonjë pyetje, nëse ka gjasa që me këtë të ekspozonte veten apo ndonjë të afërm në turp të madh, dëm të konsiderueshëm material ose ndjekje penale.

Viktima ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblim në procedurën penale.

MASA 1: GRUMBULLIMI I PROVAVE ME NDIHMËN E VIKTIMËS

Çfarë?

Pas periudhës së marrjes të vendimit, viktimashtetas i huaj, mund të vendosë:

- Mos të bashkëpunojë me organet gjyqësore;
- Të bashkëpunojë me organet gjyqësore dhe të marrë pjesë në procedurën penale.

Nëse viktimashtetas pajtohet të bashkëpunojë me organet gjyqësore, pjesëtarë të NjLKTPKM-së, pas përgatitjes së viktimës nga ana e një ekipi profesional, zhvillohet një bisedë në lidhje me eksploatimin e viktimës dhe identifikimin e kryesit të veprës penale, trafikim me qenie njerëzore.

Gjatë intervistës, duhet mbajtur llogari që intervistuesi të jetë i gjinisë të njëjtë me viktimën. Nëse ka shenja se bëhet fjalë për vepër penale trafikim me njerëz, gjatë intervistës përgatitet një procesverbal për pranim të padisë penale, që e firmos viktimashtetas.

Kur?

Në qoftë se bëhet fjalë për viktimë të vendit bashkëpunimi vazhdon që nga fillimi i procedurës e deri në fund.

Në rastin e viktimave të huaja, bashkëpunimi mbahet që nga çasti i dhënies së pëlqimit e deri në fund të procedurës gjyqësore, përveç nëse viktimia ndryshon vendimin e saj për të mos bashkëpunuar.

Kush?

- NjLKTPKM në MPB;
- Prokurori publik; dhe
- Gjykatësi hetues.

Në qoftë se bëhet fjalë për person të mitur, duhet të përfshihen prindi/kujdestari, përfaqësuesi i MNR/QPS dhe ekspertë të tjerë.

Si?

Para se të fillojë biseda viktimia duhet të informohet për:

- Të drejtat dhe përgjegjësitë gjatë bisedës nga OP e NjLKTPKM-së në MPB;
- Të drejtat dhe përgjegjësitë gjatë dhënies së dëshmisë para prokurorit publik, gjykatësit hetues dhe seancës kryesore;
- Mundësinë për të kërkuar dëmshpërblim material në procedurën penale;
- sigurinë personale dhe sigurinë e familjes së saj/tij ose të afërmëve të tjerë të viktimës;
- Fshehtësinë e procedurës dhe rrezikun nga zbulimi i informacioneve;
- Kushtet e veçanta gjatë dhënies së deklaratës në seancën kryesore;
- Mundësinë e mbylljes së seancës për publik; dhe se
- Viktimia-dëshmitar, gjatë gjithë procedurës penale, ka të drejtë të kërkojë shtyrjen e seancës/ dhënien e dëshmisë.

Nëse nevojiten informacione të tjera, ndërsa viktimia-shtetas i/e huaj është kthyer në vendbanim para gjykimit, NjLKTPKM nga MPB-ja, nëpërmjet bashkëpunimit policor ndërkombëtar, paraqet kërkesë për ta gjetur viktimën (verifikimin e identitetit dhe njoftimin për seancën gjyqësore), ndërsa gjykata me kërkesë për ndihmë juridike ndërkombëtare i drejtohet drejtpërdrejt gjykatës kompetente ose Ministrisë së Drejtësisë e cila kërkesën ia përcjell Ministrisë së Jashtme ose drejt-

përdrejt institucioneve të vendit të origjinës për trajtim dhe procedim të mëtejshëm.

Shënim: siguria dhe mirëqenia e viktimës janë prioriteti më i lartë gjatë mbledhjes së provave.

MASA 2: PËRGATITJE E VIKTIMËS PARA GJYKIMIT

Çfarë?

Qëllimi i fazës përgatitore, para fillimit të gjyqimit, është të sigurojë që viktima:

- Të jetë e vetëdijshme për të drejtat e saj, d.m.th.:
 - Të drejtën për të marrë pjesë në seancën kryesore;
 - Të drejtën për përkthim të përshtatshëm;
 - Të drejtën të mos përgjigjet në pyetje të caktuara;
 - Të drejtën të marrë pjesë aktive në seancën kryesore, të propozojë prova të reja dhe të bëjë pyetje dëshmitarëve, ekspertëve dhe të akuzuarve (nëse njëkohësisht është edhe palë e dëmtuar);
 - Të drejtën për të paraqitur kërkesë për dëmshpërblim për dëme materiale dhe jo-materiale;
 - Të drejtën për gjykim të mbyllur për publikun; si dhe
 - Të drejtën për të pasur një avokat i cili do ta përfaqësojë dhe do të marrë pjesë në mënyrë aktive në procedurën penale.
- Të jetë plotësisht i/e njoftuar me procesin gjyqësor;
- Të jetë i/e vetëdijshëm për rolin e personave të ndryshëm të përfshirë në atë proces; dhe
- T'i jepet mbështetje dhe ndihmë socio-psikologjike.

Kur?

Para, gjatë dhe pas gjyqimit.

Kush?

- Avokati në komunikim me prokurorin publik;
- Ekipet për mbështetje psiko-sociale QPS/QVT dhe OJQ; dhe
- Përfaqësues të institucioneve të tjera qeveritare.

Nëse viktima është kthyer në vend të lindjes dhe gjyqimi zhvillohet në vendin e destinacionit, viktima përgatitet në vendin e origjinës me kër-

kese nga ana e Prokurorit Publik/gjykatësit hetues nga vendi i destinacionit. Ministria e Drejtësisë fillon procedurën për marrje të ndihmës ndërkombëtare juridike

Si?

- Para datës së gjykimit, avokati ose personi përgjegjës i cakton për rastin, e shpjegon rrjedhën e procedurës gjyqësore;
- Një person për mbështetje shoqëron viktimën-dëshmitar gjatë tërë procedurës gjyqësore;
- Nëse është e mundur, viktimës-dëshmitar duhet t'i rikujtohen të gjitha deklaratat e dhëna më parë. Kjo duhet të bëhet në një ambient joformal;
- Viktima është e përgatitur për të dhënë dëshmi dhe është e informuar për rolin e saj në procedurën penale.

Nëse viktima është kthyer në vendin e origjinës, përgatitja për gjykim është një detyrim i institucioneve në vendin e origjinës.

MASA 3: MBËSHTETJE PËR VIKTIMËN GJATË SEANCËS KRYESORE

Çfarë?

Për të marrë një dëshmi nga viktima, është shumë e rëndësishme të krijohen rrethana të cilat do të:

- Zvogëlojnë në minimum rreziqet për sigurinë dhe frikësimet; dhe
- Zvogëlojnë në minimum rrezikun të një traumatizmi/viktimizimi të përsëritur.

Viktima me moshë të mitur ka të drejtë të ketë masa të veçanta mbrojtëse duke pasur parasysh interesin më të mirë të saj. Është e dëshirueshme që procedura të jetë e përshtetshme.

Kur?

Gjatë gjykimit.

Kush?

- OP nga NjMD, NjLKTPKM në MPB;
- Prokurori;
- Gjykatësi;
- I autorizuari; dhe
- Personi shoqëruar nga OJQ.

Si?

- Me vendim të gjyqit gjatë procedurës, dëgjimi bëhet me video incizim, d.m.th. deklaratat jepen në një sallë të veçantë të gjyqit në mënyrë që viktima mos të ketë nevojë të jetë personalisht e pranishme ose i akuzuari të largohet nga seanca kryesore;
- Me shmangie të kontakteve me kryesin ose të afërmit e kryesit të krimit, duke përdorur një hyrje të veçantë, dhomë të veçantë etj;
- Personat e mbështetjes duhet të qëndrojnë pranë viktimës gjatë dhënies të dëshmisë;
- Me mbyllje e gjykimit për publikun; dhe
- Duke siguruar mbrojtje për viktimat-dëshmitarë, e cila arrihet përmes përfshirjes të saj/tij në Programin e mbrojtjes të dëshmitarëve.

Në rastin e viktimave të riadhesuara në vendlindjen e tyre, kur ka nevojë që ato të paraqiten si dëshmitarë para gjykatave kompetente në Republikën e Maqedonisë, PP paraqet përmes SMPS-së një kërkesë për gjetjen dhe sigurimin e pranisë së viktimës-dëshmitar.

Në qoftë se viktima duhet të paraqitet si dëshmitar, ndërmerren aktivitete për organizimin e ardhjes të saj/tij në RM.

Në rastet kur ka mundësi teknike, dëshmitarët-viktima të trafikimit me genie njerëzore, shtetas të huaj mund të dëgjoen me anë të video-konferencës ose telefonit (LPP, Protokoli i Dytë Shtesë i Konventës për Ndihmë të Ndërsjellë Juridike në Rastet Penale).

MASA 4: MBËSHTETJE PËR VIKTIMËN-DËSHMITAR PAS PËRFUNDIMIT TË SEANCËS KRYESORE

Çfarë?

Varësisht nga vlerësimi i rrezikut, viktima-dëshmitar - shtetas i huaj, mund të kthehet në vendin e origjinës. Nëse viktima-dëshmitar (shtetas i huaj/ shtetas i RM-së), është i/e përfshirë në një program për mbrojtjen e dëshmitarëve, mund të aplikohen masat në vijim:

- Rruajtja në fshehtësi e identitetit;
- Sigurimi i mbrojtjes personale;
- Ndryshimi i identitetit; dhe
- Ndryshimi i vendbanimit / banesa e përkohshme.

Kurë?

Pas gjykimit e deri në kohën kur nuk ekziston rrezik për sigurinë e viktimave dhe të afërmeve të tyre nga çdo lloj kërcënimi për jetën, shëndetin, lirinë, integritetin fizik ose pronën.

Kush?

- NjMD në MPB;
- NjLKTPKM; dhe
- OJQ.

Si?

- Duke i ndryshuar të dhënat personale të dëshmitarit;
- Me sigurim të një vendi të sigurt për të jetuar; dhe
- Me informim paraprak të viktimës dhe të familjes për lirinë nga burgu i kryesit të veprës.

Pas përfundimit të procedurës gjyqësore vazhdon përcjellja e viktimës për të zvogëluar rrezikun nga ri-viktimizimi.

MASA 5: MBËSHTETJE PËR VIKTIMËN NË PARAQITJEN E KËRKESËS PËR DËMSHPËRBLIM MATERIAL GJATË PROCEDURËS PENALE

Çfarë?

Viktima ka të drejtë të kompensohet nga ana e kryesit për dëmin e shkaktuar. Kompensimi i viktimës realizohet me paraqitjen e një kërkesë për dëmshpërblim në procedurën penale. Kërkesa për dëmshpërblim paraqitet në gjykatën ku zhvillohet procedura.

Gjykata penale vendos për kërkesën për dëmshpërblim. Domethënë, me aktgjykimin me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, gjykata vendos plotësisht ose pjesërisht për kërkesën për dëmshpërblim. Nëse dëshmitë në procedurën penale nuk sigurojnë baza të mjaftueshme për një vendim të plotë ose të pjesëshëm për kërkesën për dëmshpërblim, ndërsa për t'i siguruar ato ekziston mundësia e shtyrjes së procesit pa arsye, gjykata me aktgjykimin vendos vetëm për bazën, ose bazën dhe pjesërisht shumën e dëmshpërblimit, ndërsa për shumën e plotë sjell një vendim plotësues.

Për të siguruar kompensimin gjatë procedurës penale mund të vendosen masa të përkohshme për kompensim të dëmit që ka ndodhur

për shkak të veprës penale. Këto masa të sigurimit të parave ose pronës së përkohshme parashohin gjithashtu ngrirje, konfiskim, mbajtje të përkohshme të fondeve, llogarive bankare dhe transaksioneve financiare ose të ardhurave të tjera të fituara nga vepra penale

Nëse shumica e kërkesës për dëmshpërblim nuk mund të përcaktohet me prova të tjera ose në qoftë se paraqitja e provave të tilla do të çonte deri të shtyrja e procedurës, gjykata do të nxjerrë një vendim plotësues lidhur me shumën e kërkesës për dëmshpërblim ose një pjesë të saj, duke caktuar një kompensim në para.

Në rast nevojë, zbatohen dispozitat e KP-së për konfiskim të zgjeruar.

Në rast të një vendimi të pafajësisë, gjykata e këshillon palën e dëmtuar ta realizojë kërkesën në një procedurë civile

Kur?

Jo më vonë se përfundimi i shqyrtimit kryesor para gjykatës së shkallës së parë.

Kush?

Kërkesën e paraqet viktimë përmes avokatit të saj/tij.

Në rastin e viktimave të mitur, kërkesa mund të paraqitet nga prindërit, kujdestarët dhe përfaqësuesit ligjor.

Si?

- Duke e informuar viktimën për të drejtat që i ka të kompensimit në suaza të procedurës gjyqësore dhe për pjesëmarrjen aktive në të;
- Duke siguruar ndihmë ligjore falas në rrjedhën e procedurës; dhe
- Duke e informuar viktimën-shtetase të huaj me anë të avokatit për ecurinë e procedurës civile e cila zhvillohet në vendin e destinacionit

PJESA C

ANEKSI 1: LISTA E ORGANIZMAVE PËRGJEGJËSE PËR PSO

Maqedonia		
Masa	Organizma përgjegjës	Kontakte
Identifikim dhe eferim	<p>Njësia për luftën kundër trafikimit të personave dhe kontrabandimit të emigrantëve, Ministria e Punëve të Brendshme; Shkup</p> <p>Zyra e mekanizmit kombëtar të referimit, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Shkup</p>	<p>Sande Kitanov, shef Adresa: Dime Mirçev p.n. 1000 Shkup Tel: +389 2 3116280 Faks: +389 2 3142201 Mob: +389 70 323497 E-mail: sande_kitanov@moi.gov.mk</p> <p>Elena Grozdanova, këshilltar shtetëror Adresa: Dame Gruev 14, 1000 Shkup Tell: +389 2 3129308 Mob:+389 75 311726 E-mail: egrozdanova@mtsp.gov.mk</p> <p>Svetllana Cvetkovska, koordinatore nacionale Adresa: Dame Gruev 14, 1000 Shkup Tel: +389 2 3 106 443 Mob: +389 76 456795 E-mail: scvetkovska@mtsp.gov.mk; nmuofficemk@yahoo.com</p>
Kujdes fillestar dhe asistencë afatmesme	<p>Njësia për luftën kundër trafikimit të personave dhe kontrabandimit të emigrantëve, Ministria e Punëve të Brendshme; Shkup</p> <p>Zyra e mekanizmit kombëtar të referimit, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Shkup</p>	<p>Sande Kitanov Shef Adresa: Dime Mirçev pn,1000 Shkup Tel: +389 2 3116280 Faks: +389 2 3142201 Mob: +38970323497 E-mail: sande_kitanov@moi.gov.mk</p> <p>Elena Grozdanova, këshilltar shtetëror Adresa: Dame Gruev 14, 1000 Shkup Tell: +389 2 3129308 Mob:+389 75 311726 E-mail: egrozdanova@mtsp.gov.mk</p> <p>Svetllana Cvetkovska, koordinatore nacionale Adresa: Dame Gruev 14,1000 Shkup</p>

	<p>OJQ “Porta e Hapur”, Shkup</p> <p>OJQ “Për fëmijëri të lumtur”, Shkup</p>	<p>Tel: +389 2 3106443 Mob: +389 76 456795 E-mail: scvetkovska@mtsp.gov.mk; nmuofficemk@yahoo.com</p> <p>Maja Varoshlija Tel/Faks:+389 2 2700107 Mob.: +389 70 367639 E-mail: mvaroslija@lastrada.org.mk; lastrada@on.net.mk</p> <p>Verica Stamenkova Trajkova Tel: +389 2 2615628 +389 2 2622491 Faks: +389 2 3118143 Mob.: +389 70 227289 E-mail: za.srekno.detstvo@gmail.com; vericatrajkova@gmail.com</p>
Kthimi	<p>Njësia për luftën kundër trafikimit të personave dhe kontrabandimit të emigrantëve, Ministria e Punëve të Brendshme; Shkup</p> <p>Spektori i punëve kufitare; Ministria e Punëve të Brendshme; Shkup</p> <p>Organizata Ndërkombëtare e Migrimit – IOM</p> <p>Qendra e pranimit për të huaj; Shkup</p>	<p>Sande Kitanov Shef Adresa Dime Mirçev, p.n. 1000 Shkup Tel: +389 2 3116280 Faks: +389 2 3142201 Mob: +389 70 323497 E-mail: sande_kitanov@moi.gov.mk</p> <p>Jovançe Asprovski Adresa: Dime Mirçev, p.n. 1000 Shkup Tel: +389 2 3238034 Faks:+389 2 3143335 Mob:+389 70 364370 E-mail: jovance_asprovski@moi.gov.mk</p> <p>Ivona Z. Todorovska, Kontakt i anti-trafikimit Tel: +389 2 3088100 E-mail: izakoska@iom.int</p> <p>Pero Sharevski Tel/Faks:+389 2 3142613 Mob: ++389 70 276022</p>
Riintegrimi	Zyra e mekanizmit kombëtar të referimit, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Shkup	<p>Elena Grozdanova, këshilltar shtetëror Adresa: Dame Gruev 14, 1000 Shkup Tel: +389 2 3129308 Mob:+389 75 311726 E-mail: egrozdanova@mtsp.gov.mk</p>

	<p>OJQ “Porta e Hapur“, Shkup</p> <p>OJQ “Për fëmijëri të lumtur“, Shkup</p>	<p>Svetllana Cvetkovska, koordinatore nacionale Adresa: Dame Gruev 14,1000 Shkup Tel: +389 2 3 106443 Mob: +389 76 456795 E-mail: scvetkovska@mtsp.gov.mk; nmuofficmk@yahoo.com</p> <p>Maja Varoshlija znj Tel/Faks:+389 2 2700107 Mob.: +389 70 367639 E-mail: mvaroslija@lastrada.org.mk; lastrada@on.net.mk</p> <p>Verica Stamenkova Trajkova Tel: +389 2 2615628 +389 2 2622491 Faks: +389 2 3118143 Mob.: +389 70 227289 E-mail: za.srekno.detstvo@gmail.com; vericatrajkova@gmail.com</p>
Procedurë penale	<p>Prokuroria Publike; Prokuroria Publike e Shkallës së Parë për luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit; Shkup</p> <p>Njësia për mbrojtjen e dëshmitarëve; Ministria e Punëve të Brendshme; Shkup</p> <p>Njësia për luftën kundër trafikimit të personave dhe kontrabandimit të emigrantëve, Ministria e Punëve të Brendshme; Shkup</p> <p>Zyra e mekanizmit kombëtar të referimit, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Shkup</p>	<p>Vlatko Georgievski Tel: +389 2 3219850 Faks: +389 2 3219866 Mob:+389 70 397822 E-mail: vlatko.georgievski@jorm.gov.mk</p> <p>Lupço Fidanovski Tel: +389 2 3225765 Faks: +389 2 3142277 Mob: +389 70 330347 E-mail: ljupco_fidanovski@moi.gov.mk</p> <p>Sande Kitanov, shef Adresa: Dime Mirçev pn, 1000 Shkup Tel: +389 2 3116280 Faks: +389 2 3142201 Mob: +389 70 323497 E-mail: sande_kitanov@moi.gov.mk</p> <p>Lençe Kocevski Adresa: Dame Gruev 14, 1000 Skopje Tel: +389 2 3129308 Mob:+389 76 456119 E-mail: lkoceva@mtsp.gov.mk</p>

ANEKSI 2: LISTA E ORGANIZMAVE TË BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTARË

Do të vendosen kontakte mes organizatave dhe institucioneve përgjegjëse për trajtimin e viktimave të trafikimit me njerëz.

Shqipëri		
Masa	Organizma përgjegjës	Kontakte
Identifikimi	Spektori kundër trafiqeve të paligjshme, Drejtoria kundër krimit të organizuar, Policia kufitare dhe e migracionit, Ministria e Punëve të Brendshme; Tiranë	Znj. Anila Trimi Tel.:+355 4 2279303 Faks:+355 4 2273447 Mob:+355 69 4102005 E-mail: trimia@mrp.gov.al
Kujdes urgjent në rast krize	Drejtoria e shërbimeve sociale, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta; Tiranë	Znj. Ilda Poda Tel.:+355 4 2243947 Mob:+355 68 2348001 E-mail: ildapoda@yahoo.com
Ndihmë për rehabilitim dhe riintegrim	Drejtor ekzekutiv; OJQ Mundësi të ndryshme dhe të barabarta, Tiranë	Znj. Marjana Meshi/Muslia Tel:+355 4 2254532 Mob:+355 69 2088696 E-mail: mmeshi@yahoo.co.uk
Kthim	Shef i sektorit të ripranimit - Drejtoria e kufijve dhe migracionit, Ministria e Punëve të Brendshme, Tiranë	z. Ylli Kumrija Tel:+355 4 2279251 Fax:+355 4 2279263 Mob:+355 69 4102357 E-mail: kumrijay@mrp.gov.al
Procedura penale dhe kërkesa për dëmshpërblim	Prokurori, Prokuroria Publike, Tiranë Prokurori, Gjykata e Krimeve të Rënda, Tiranë	z. Arqilea Koca Tel:+355 4 2222950/1069 Mob:+355 69 2078630 E-mail: akoca@pp.gov.al z. Ened Nakuci Tel: +355 4 2254326 Mob: +355 69 2076220 E-mail: enakuci@pp.gov.al

Të dhëna të kontakteve rajonale (shërbime shtetërore sociale) për referimin e rasteve të trafikimit të qenieve njerëzore			
Emri, qyteti	Telefon	Celular	Faks
z. Mihail Naçi, Drejtor i përgjithshëm i shërbimit social, Ministria e Punës, Çështjeve Socialë dhe Shanseve të Barabarta; Tiranë	+355 42 230719	+355 68 2082050	+355 4 2230719
Shërbime shtetërore sociale, (z. Lulzim Konçi); Tiranë	+355 42 348645	+355 68 2135136 +355 69 2074135	+355 4 2348645
Shërbime shtetërore sociale (znj Luljeta Tavani); Berat	+355 322 35610 322 34141	+355 68 2637283	+355 32 234141
Shërbime shtetërore sociale (z. Emil Buka); Gjirokastër	+355 84 264557 84 265331	+355 69 2165116	+355 84 265331
Shërbime shtetërore sociale (z. Ylber Brahimaj); Vlorë	+355 33 227891	+355 69 2094089	
Shërbime shtetërore sociale (znj Rita MOÇO); Fier	+355 34 22567 34 23638	+355 68 2338999	+355 34 223638
Shërbime shtetërore sociale (znj Brunilda Dulaj); Elbasan	+355 54 252246	+355 69 5424095	+355 54 252246
Shërbime shtetërore sociale (znj Marjana Hamiti); Durrës	+355 52 26096	+355 69 3798602	
Shërbime shtetërore sociale (z. Shukri MEHMETI); Kukës	+355 24 23287 24 24562	+355 68 2095610	+355 24 24562
Shërbime shtetërore sociale (z. Shukri SHEHI); Dibër	+355 21 83279 21 82157	+355 68 2777856	+355 21 82157

Shërbime shtetërore sociale (z. Gjergj LULAJ); Lezhë	+355 21 52547 21 53586	+355 68 2086778	+355 21 53586
Shërbime shtetërore sociale (znj Mirela SHIROKA);	+355 22 48907 22 48907	+355 68 4014613	+355 22 48907
Shërbime shtetërore sociale (z. Ilir Frashëri); Korçë	+355 82 242539	+355 68 2085949	+355 82 242539

Bosnja dhe Hercegovina		
Masa	Organizma përgjegjës	Kontakte
Identifikim	Zyra e koordinatorit nacional për luftë kundër trafikimit me qenie njerëzore, Sarajevë	Zyra e koordinatorit nacional për luftë kundër trafikimit me qenie njerëzore dhe migrime të paligjshme Adresa: Godina e miqësisë mes Greqisë dhe Bosnjës dhe Hercegovinës Kati 12; zyra nr. 1224 Sheshi i BH-së 1, 71000 Sarajevë Tel/faks:+387 33 492454; +387 33 710531 E-mail: uredk@msb.gov.ba
Kujdes urgjent në rast krize	Zyra e koordinatorit nacional për luftë kundër trafikimit me qenie njerëzore, Sarajevë	Zyra e koordinatorit nacional për luftë kundër trafikimit me qenie njerëzore dhe migrime të paligjshme Adresa: Godina e miqësisë mes Greqisë dhe Bosnjës dhe Hercegovinës Kati 12; zyra nr. 1224 Sheshi i BH-së 1, 71000 Sarajevë Tel/faks:+387 33 492454; +387 33 710531 E-mail: uredk@msb.gov.ba
Ndihmë për rehabilitim dhe riintegrim	Zyra e koordinatorit nacional për luftë kundër trafikimit me qenie njerëzore, Sarajevë	Zyra e koordinatorit nacional për luftë kundër trafikimit me qenie njerëzore dhe migrime të paligjshme Adresa: Godina e miqësisë mes Greqisë dhe Bosnjës dhe Hercegovinës Kati 12; zyra nr. 1224 Sheshi i BH-së 1, 71000 Sarajevë Tel/faks:+387 33 492454; +387 33 710531 E-mail: uredk@msb.gov.ba

Kthim	Zyra e koordinatorit nacional për luftë kundër trafikimit me qenie njerëzore, Sarajevë	Zyra e koordinatorit nacional për luftë kundër trafikimit me qenie njerëzore dhe migrime të paligjshme Adresa: Godina e miqësisë mes Greqisë dhe Bosnjës dhe Hercegovinës Kati 12; zyra nr. 1224 Sheshi i BH-së 1, 71000 Sarajevë Tel/faks: +387 33 492454; +387 33 710531 E-mail: uredk@msb.gov.ba
Procedura penale dhe kërkesa për dëmshpërblim	Zyra e koordinatorit nacional për luftë kundër trafikimit me qenie njerëzore, Sarajevë	Zyra e koordinatorit nacional për luftë kundër trafikimit me qenie njerëzore dhe migrime të paligjshme Adresa: Godina e miqësisë mes Greqisë dhe Bosnjës dhe Hercegovinës Kati 12; zyra nr. 1224 Sheshi i BH-së 1, 71000 Sarajevë Tel/faks: +387 33 492454; +387 33 710531 E-mail: uredk@msb.gov.ba

Bullgaria		
Masa	Organizma përgjegjës	Kontakte
Identifikim	<p>Komisioni nacional i luftës kundër trafikimit me njerëz, Sofje</p> <p>Sektori "Trafikimi me njerëz"; Drejtoria "Luftë kundër krimit të rëndë dhe të organizuar"; Drejtoria kryesore "Policia e krimit"; Ministria e Punëve të Brendshme; Sofje</p> <p>Organizata ndërkombëtare e Migracioneve (IOM), Sofje</p>	<p>Adresa: Blvd. "G.M.Dimitrov" 52A, kati 1, 1797 Sofje Tel: +359 2 8078050; +359 2 8078052 Faks: +359 2 8078059 E-mail: office@antittraffic.government.bg</p> <p>Adresa: blvd, Tsarigradsko Shose 1331707 Sofje Tel: +359 2 9828038 Faks: +359 2 9885902 E-mail: 170@mvr.bg</p> <p>Adresa: rr. Knyaz Boris I 145 b, 1000 Sofje Tel: +359 2 9394774 Faks: +359 2 9394788 Hotline: +359 2 9394777 E-mail: iomSofje@iom.int</p>

<p>Kujdes urgjent në rast krize</p> <p>Ndihmë për rehabilitim dhe riintegrim</p>	<p>Komisioni nacional i luftës kundër trafikimit me njerëz, Sofje</p> <p>OJQ Animus Asociacija; Sofje</p> <p>Organizata ndërkombëtare e Migracioneve (IOM); Sofje</p>	<p>Adresa: Blvd. "G.M.Dimitrov" 52A, kati 1, 1797 Sofje Tel: +359 2 8078050; +359 2 8078052 Faks:+359 2 8078059 E-mail: office@antitraffic.government.bg</p> <p>Adresa: "Ekzarh Yossif" Street 85, 1000, Sofje Tel/Faks: +359 2 9835205; +359 2 9835305; +359 2 9835405. Linja e hapur: +359 2 9817686 E-mail: animus@animusassociation.org</p> <p>Adresa: rr. Knyaz Boris I, 145 b, 1000 Sofje Tel:+359 2 9394774 Faks:+359 2 9394788 Linja e hapur:+359 2 9394777 E-mail: iomSofje@iom.int</p>
<p>Kthim</p>	<p>Komisioni nacional i luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore, Sofje</p> <p>Sektori "Trafikimi me njerëz"; Drejtoria "Luftë kundër krimit të rëndë dhe të organizuar"; Drejtoria kryesore "Policia e krimit"; Ministria e Punëve të Brendshme; Sofje</p> <p>Organizata ndërkombëtare e Migracioneve (IOM); , Sofje</p>	<p>Adresa: Blvd. "G.M.Dimitrov" 52A, kati 1, 1797 Sofje Tel: +359 2 8078050; +359 2 8078052 Faks:+359 2 8078059 E-mail: office@antitraffic.government.bg</p> <p>Adresa: blvd Carigradsko Shose 133, 1707 Sofje Tel: +359 2 9828038 Faks: +359 2 9885902 E-mail: 170@mvr.bg</p> <p>Adresa: rr. Knyaz Boris I, 145 b, 1000 Sofje Tel:+359 2 9394774 Faks:+359 2 9394788 Hotline:+359 2 9394777 E-mail: iomSofje@iom.int</p>
<p>Procedura penale dhe kërkesa për dëmshpërblim</p>	<p>Komisioni nacional i luftës kundër Trafikimit me njerëz, Sofje</p>	<p>Adresa: Blvd. "G.M.Dimitrov" 52A, kati1,1797 Sofje Tel: +359 2 8078050; +359 2 8078052</p>

	Prokuroria e Lartë e Kasacionit; Sofje	Faks: +359 2 8078059 E-mail: office@antitrafic.government.bg Adresa: Blvd, "Vitosha" 2, 040 Sofje Tel: +359 2 9219235 Faks: +359 2 9219452
--	--	---

Kroaci		
Masa	Organizma përgjegjës	Kontakte
Identifikim	Njësia e krimit të organizuar; Ministria e Punëve të Brendshme; Zagreb	Znj. Katrin Gluic Tel: +385 99 7320242 E-mail: kgluic@mup.hr
Kujdes urgjent në rast krize	Grupet mobile; Kryqi i Kuq i Kroacisë; Zagreb	Znj. Selma Golubović Tel: +385 99 3114862 E-mail: selma.golubovic@hck.hr
Ndihmë për rehabilitim dhe riintegrim	Grupi operativ; Zyra e të drejtave të njeriut (koordinator nacional); Zagreb	Zyra e koordinatorit nacional Znj. Maja Buksa; Sekretariati i komitetit nacional Anti-Trafikim Tel: +385 1 4877660 Fax: +385 1 4813430 E-mail: mbuksa@ljudskaprava-vladarh.hr
Kthim	Njësia e migracionit ilegal; Ministria e Punëve të Brendshme; Zagreb	Znj. Lidija Pentavec Tel: +385 1 3788559 Fax: +385 1 37 88158 E-mail: lpentavec@mup.hr
Procedura penale dhe kërkesa për dëmshpërblim	Prokuroria Publike e Kroacisë; Zagreb	Znj. Andrea Shurina Marton Tel: +385 98 466695; +385 49 426900 Fax: +385 49 467650 E-mail: andrea.surina@zg.t-com.hr; zdo-zlatar@kr.htnet.hr

Kosovë		
Masa	Organizma përgjegjës	Kontakte
Identifikimi	Njësia policore e luftës kundër trafikimit me njerëz, Ministria e Punëve të Brendshme; Prishtinë	Z. Ramadan Ahmeti, Komandant, trafikim me njerëz Tel: +377 44 506097 E-mail: shtqnj@gmail.com Znj. Leonora Krasniqi, Sektori i trafikimit me njerëz,

